



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë për
Zhvillimin Bujqësor dhe Rural**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT”

Tiranë, shkurt 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7
8.	Dokumentimi i auditimit	8
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	8-14
1	Verifikimi i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK	
2.2	Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit	14-34
1	Procedurat e investimeve në fushën e TIK	
2.3	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output	34-52
IV.	REKOMANDIME	53-62

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, nga data 24.09.2024 deri në 11.11.2024.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në AZHBR, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në AZHBR.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1078/1, me datë 24.09.2024.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, AZHBR nuk ka plan trajnimi vjetor të miratuar për teknologjinë e informacionit, në kundërshtim me ligjin Nr. 10296 datë 16.09.2016 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 20, pika 2 ç: “Politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore”.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në raportet e veta 3, 6, 9 dhe 12 mujore bën sugjerime të përgjithshme për fushat e interesit që drejtoria ka si nevoja për trajnime.

- Nga auditimi konstatohet se aplikimet për masat e investimeve për vitin 2024 po realizohen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR, megjithëse këto aplikime mund të kryhen përmes sistemit të ri SMI Skemat Kombëtare, pasi konfigurimet dhe funksionalitetet e nevojshme janë zhvilluar dhe testuar. Mospërdorimi i sistemit rrezikon të kufizojë efektivitetin e tij në të ardhmen, duke penguar arritjen e qëllimit për të cilin AZHBR ka investuar dhe duke e kthyer këtë investim në një shpenzim të paefektshëm.

- Nga auditimi i raporteve mujor të mirëmbajtjes të sistemit SMI IPARD për periudhën 16.06.2023 deri në 18.06.2024 u konstatua se, çdo muaj ka pasur ndryshime/përditësime si në modulet, workflow-t dhe funksionalitetet ekzistuese nga marrja në dorëzim e sistemit. Konstatohet se përmirësimi i sistemit SMI IPARD në lidhje me funksionimin, përmirësimin e moduleve ekzistuese, trajtimin dhe procesimin e aplikimeve për të përfutur nga programi IPARD ende nuk e ka arritur qëllimin për informatizimin e të gjitha hapave të procesit nëpërmjet përdorimit të sistemit, si në lidhje me workflow-n ashtu dhe me veprimet operacionale të AZHBR-ës. Kjo situatë sjellë risk në ndërprerjen e shërbimit dhe vazhdimësisë së funksionimit të sistemit në momentin e hapjes së thirrjeve si dhe zhvillimit të të gjithë procesit nëpërmjet sistemit.

- Kanë rezultuar probleme me funksionalitetet e filtrave në sistem:

- Filtri sipas “App ID” jep të gjitha aplikimet që përmbajnë një nga numrat e filtruar, duke mos ofruar rezultate të sakta;
- Filtri sipas datës nuk kthen asnjë rezultat, duke mos shfaqur asnjë informacion;
- Filtri sipas fushës “Të përcaktuarit” gjeneron error në sistem, duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë;
- Gjatë përdorimit të filtrave të tjerë, shfaqet mesazhi i gabimit: “Ndodhi një problem. Në rast se problem vazhdon, ju lutem kontaktoni administratorin e sistemit.”

Ndërveprimi me sisteme të tjera (RUDA, ISSH, etj.):

- Sistemi nuk lejon mbylljen e tab-it me informacionin përkatës, duke detyruar përdoruesin të rikthehet në faqen kryesore, çka ndërpret procesin e filtrimit dhe aplikimit.

Mungesa e kontrollit të automatizuar për financimet e dyfishta:

- Verifikimet për financime të dyfishta (nëse përfituesi është debitor ndaj MBZHR dhe AZHBR) kryhen manualisht nga punonjësit. Punonjësit përdorin formate excel të përditësuara çdo vit dhe i krahasojnë manualisht me informacionin e ruajtur nga MBZHR.
- Në sistem nuk ka standardizim për të automatizuar këto verifikime.

Mungesa e funksionalitetit të ankimeve në sistem:

- Sistemi i ri SMI Skemat Kombëtare nuk lejon aplikantët të depozitojnë ankesa në mënyrë dixhitale, pavarësisht përcaktimit të këtij funksionaliteti në manualin e përdorimit. Aplikantët vazhdojnë të depozitojnë ankesa fizikisht ose përmes e-mailit.
- Trajtimi i ankesave realizohet manualisht dhe njoftimi i aplikantëve bëhet përmes telefonit ose e-mailit, duke mos përdorur sistemin për transparencë dhe efikasitet.

- Nga auditimi mbi veprimtarinë e punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm, u konstatua se:

1. Kjo strukturë nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 8 dhe 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.

2. Në strukturë mungojnë ekspertët e fushës TIK në kundërshtim me “Manualin e auditimit të brendshëm” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, pika “2.4.4 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit”.

3. Nuk janë zhvilluar burimet njerëzore me njohuri për auditimin e TI-së në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4. pika 6, nenit 9 dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të analizojë dhe të identifikojë nevojën e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit dhe të marrë masa për miratimin e planit vjetor të trajnimeve të DTI.

- Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për automatizimin e shërbimeve për të cilat është investuar për këtë sistem, duke vendosur në funksionim të plotë fillimin e përdorimit dhe popullimin e moduleve në lidhje me aplikimet e masave për investim të cilat janë implementuar në sistem nga të gjitha strukturat sipas detyrave dhe funksioneve përkatëse.

- Strukturat drejtuese në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit të identifikojnë, analizojnë dhe prioritarizojnë, burimet, nevojat për përmirësimin dhe përditësimin e sistemit, si dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete me qëllim finalizimin e plotë të të gjithë procesit të informatizuar, dixhitalizuar dokumentat dhe proceset sipas veprimeve operationale dhe nevojës së përdoruesve në sistem.

- Strukturat drejtuese të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune që të analizojë, adresojë parregullsitë dhe mangësitë e identifikuar dhe të propozojë zgjidhje konkrete, për automatizimin e plotë të shërbimeve në lidhje me:

- Përdorimin e sistemit dhe funksionalitetet e tij,
- Kontrollin e financimeve të dyfishta,
- Mundësimin e ankimimit të aplikantëve përmes sistemit SMI Skemat Kombëtare.

- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të marrë masa të përfshijë në programet e auditimit të brendshëm dhe auditime IT, periodike sa herë ka ndryshime ligjore në funksionimin e

sistemeve dhe infrastrukturave TIK. Gjithashtu, AZHBR të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe me punonjës të profilit përkatës dhe njohuri specifike të teknologjisë së informacionit, që gëzojnë ekspertizën e nevojshme për kryerjen e këtyre auditimeve. Punonjësit të trajnohen vazhdimisht, në përputhje me nevojat e stafit për trajnim dhe standardeve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300, Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 5310, Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, gjetjet e auditimit, evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri më datën 30.06.2024, vlerësojmë se sistemi informatik për menaxhimin e aplikimeve për përfitim nga grantet që janë dhënë në kuadër të implementimit të projektit IPARD, si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit për aplikimet e bëra me qëllim përfitimin nga skemat e subvencioneve që mbështet AZHBR, ende nuk e kanë arritur qëllimet e investimeve të kryera në lidhje me informatizimin e të gjitha hapave të procesit nëpërmjet përdorimit të sistemit, zhvillimin e shërbimeve si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë në ofrimin e shërbimeve. Zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë, ku me gjithë përpjekjet dhe investimet në fushën e teknologjisë, situata në AZHBR në këtë drejtim nuk është e konsoliduar në krahasim me investimet e kryera. Gjithashtu, kontrollet për financim të dyfishtë realizohen manualisht dhe nuk mundësohet ankimimi i aplikantëve përmes sistemit. Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pamjaftueshëm.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 1078/1 prot., datë 24.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.09.2024 deri më datë 11.11.2024, në subjektin “Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.S, përgjegjës grupi;
2. M.P, audituese;
3. A.M, audituese.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në AZHBR, nga data 24.09.2024 deri më datë 11.11.2024. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 1078/1 prot, datë 24.09.2024:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

- 1.1 Verifikimi i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK
2. Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit
 - 2.1 Procedurat e investimeve në fushën e TIK
3. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si agjencia e pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, është person juridik publik në varësi të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

AZHBR është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si më poshtë vijon:

- a) Fondeve të buxhetit të shtetit;
- b) Fondeve kundërpartit, të projektit 2KR;
- c) Fondeve të Bashkimit Evropian;
- ç) Fondeve të siguruar nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.

Misioni i AZHBR-së është zhvillimi Agrikulturor dhe Rural në Shqipëri duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.

Vizioni i AZHBR-së, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE, është fokusuar në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përftohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi AZHBR mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 30.06.2024, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që janë implementuar në sistemet informatike.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 1078/1 prot., datë 24.09.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon institucioni nën auditim si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, *“Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”*;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 719 datë 31.10.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 *“Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”*;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;
- Manuali i Auditimit IT;
- Standardet TIK, si COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, si dhe ISSAI 5300 Udhëzime për auditimin e IT-së, ISSAI 100 Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, etj.

7. Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;

- Shqyrtimi i dokumentacioneve për sistemet informatike që institucioni disponon;
- Shqyrtimi i informacioneve dhe raporteve të institucionit në auditim;
- Intervista të zhvilluara me personelin kyç të AZHBR;
- Verifikimi dhe analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, është person juridik publik në varësi të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e ka selinë në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

AZHBR ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë. AZHBR organizohet në nivel qendror, nëpërmjet zyrës qendrore, dhe në nivel vendor, nëpërmjet agropikave, ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë.

AZHBR ka për detyrë:

- a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe masa të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, nëpërmjet:
 - i) ofrimit të shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor që ushtrjnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në seli dhe në terren;
 - ii) orientimit të veprimtarisë së fermerëve në përputhje me drejtimit e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - iii) zhvillimit të procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme;
- b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
- c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
- ç) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;
- d) të zbatojë masat e kontrollit dhe auditit të brendshëm;
- dh) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
- e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

1. Verifikimi i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

Trajtimi i këtij drejtimi të auditimit është bazuar në dokumentacionin si më poshtë:

1. Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
2. Rregullorja e brendshme e AZHBR;
3. Lista e punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit (DTI) dhe përshkrimet e detyrave funksionale sipas organizimit hierarkik të drejtorisë;
4. Raportet periodike të DTI mbi ecurinë e veprimtarisë së drejtorisë;
5. Planet vjetore të auditit të brendshëm, struktura e sektorit të auditimit të brendshëm dhe raportet e auditimeve;
6. Planet e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut;
7. Pyetësorët dhe intervistat zhvilluar me punonjësit e DTI.

Burimet Njerëzore në TIK

Veprimtaria dhe funksionimi i brendshëm i institucionit bazohet në Udhëzimin Nr.17 datë 19.10.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e brendshëm të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”. Veprimtaria e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit (DTI) bazohet mbi detyrat funksionale që rrjedhin nga rregullorja e brendshme institucionale. Gjithashtu, rregullorja e brendshme është në proces ndryshimi dhe përshtatje në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e miratuara në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 93, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”.

Misioni i punës së DTI është të sigurojë menaxhimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe të mbikëqyrë mbarëvajtjen e tyre në përputhje me zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve, sipas programit qeveritar, Marrëveshjes Kuadër dhe Marrëveshjes Sektoriale, si edhe në mbështetje të funksionimit të proceseve të punës të AZHBR.

DTI (5+1) përbëhet nga 1 (një) drejtor dhe 5 (pesë) specialistë. Bazuar në përgjigjet e pyetësorit “Kërkesë për informacion/dokumentacion për “Auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)”, arsyeja pse struktura përgjegjëse TIK e AZHBR, nuk ka kaluar si pjesë e strukturës së AKSHI-t, sipas përcaktimeve të pikës 23 të VKM nr. 673 bazohet në marrëveshjen Kuadër dhe Sektoriale midis Shqipërisë dhe BE. Sipas AZHBR një ndër kushtet që duhen përmbushur për të marrë akreditimin e Agjencisë për administrimin e fondeve të BE, është që funksioni i IT të jetë pjesë e brendshme e AZHBR.

Struktura e DTI për periudhën e auditimit paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

Tabela nr.1: Struktura e DTI për periudhën e auditimit

Viti	Emer	Mbiemer	Funksioni
2022	V.	Z.	Drejtor
	A.	P.	Specialist
	R.	P.	Specialist
	K.	H.	Specialist
	A.	A.	Specialist
	Vakant		Specialist
2023	K.	H.	Drejtor
	A.	A.	Specialist
	A.	P.	Specialist
	A.	H.	Specialist
	Vakant		Specialist
	Vakant		Specialist
2024 (01.01.2024-30.06.2024)	K.	H.	Drejtor

	A.	P.	Specialist
	A.	A.	Specialist
	Vakant		Specialist
	Vakant		Specialist
	Vakant		Specialist

Burimi: Të dhëna nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në AZHBR

Grupi i auditimit konstaton se brenda periudhës objekt auditimi ka pas disa ndryshime të burimeve njerëzore në DTI, shoqëruar kjo dhe me vakanca për funksionin “specialist”, përkatësisht 1 (një) vakancë në vitin 2022, 2 (dy) në vitin 2023 dhe 2 (dy) në vitin 2024 (pasi z. A.H ka qenë pjesë e DTI dhe është larguar me transferim të përhershëm në Gusht 2024). Duke marrë në konsideratë volumin e punës të drejtorisë për shkak të implementimit të Programit IPARD III vakancat ndikojnë drejtëpërdrejtë në përmbushjen e detyrave funksionale dhe qëllimeve të drejtorisë.

Detyrat kryesore të specialistëve të kësaj drejtorie janë:

- Menaxhojnë, mbikëqyrin dhe sigurojnë funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit dhe bazat e ruajtjes së të dhënave.
- Komunikojnë dhe raportojnë problematika që janë të zgjidhshme nën autoritetin e Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
- Përgatisin raportet javore/mujore në lidhje me punën e kryer, problematikat/defektet e hasura në punën e përditshme të gjithë Agjencisë;

DTI në realizimin e detyrave funksionale, përveç rregullores së brendshme të AZHBR dhe rregulloreve të miratuara nga AKSHI, bazohet edhe në Manualin e Procedurave, të miratuar në Paketën EBIT (Entrustment Budget Implementation Package) nga DG-AGRI, për zbatimin e Programit IPARD II. Aktualisht këto procedura po rishikohen në kuadër të implementimit të Programit IPARD III dhe do të përcillen për miratim dhe akreditim në organet përkatëse të BE.

Me urdhër të brendshëm të Titullarit të Institucionit Nr.285, datë 28.06.2022 me objekt: “Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sigurinë e informacionit në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” është caktuar z. H.M, si zyrtar përgjegjës për sigurinë (Information Security Officer) në AZHBR, në përputhje dhe me Manualin e Procedurave. Urdhri përcakton dhe detyrat që duhet të përmbushi zyrtari, si: përgatitja e dokumentave dhe formularëve për punën në institucion në fushën e sigurisë së informacionit dhe përgatitja e propozimeve për ndryshimet e tyre, marrja pjesë në përgatitjen e dokumentave që përmbajnë analizën e ekspertëve për çështje të rëndësishme të legjislacionit në fuqi, propozime për planet e punës në institucion dhe raportin për ecurinë e punës, sigurimi i funksionimit të sigurt të sistemeve të informacionit të agjencisë, etj.

Institucioni me shkresën Nr.274/2 prot., datë 16.02.2024, me lëndë: “Kërkesë për propozim për ndryshimin e strukturës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, ka përcjellë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, relacionin lidhur me propozimin për ndryshimin e strukturës. Pjesë e propozimeve është dhe shtimi i pozicionit të Oficerit të Sigurisë, si nevojë e dal nga rekomandimet e auditimeve të realizuara në institucion. Zyrtari përgjegjës do të kryej të gjitha detyrat të cilat ngarkohen me urdhër të brendshëm nga Titullari i Institucionit për Oficerin e Sigurisë, me qëllim sigurimin që vetëm personeli i përshtatshëm të ketë akses në informacion kritik, duke mbikëqyrur proceset e punës dhe duke marrë masat përkatëse në përputhje me standardin ISO 27002.

Me anë të shkresës Nr. 1521/2 prot., datë 01.03.2024, me lëndë: “Kthim përgjigje”, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka analizuar propozimet duke i kategorizuar në tre aspekte:

1. Propozime për shtesa në strukturën aktuale;
2. Propozime lidhur me përmirësimin e strukturës aktuale në secilën drejtori;

3. Propozime lidhur me ndryshimet e kategorive të pagave në institucion. Ministria aprovon kërkesën e AZHBR për shtimin e pozicionit të Oficerit të Sigurisë, me arsyetimin se ky pozicion do të shërbej si një hallkë shumë e rëndësishme në marrjen e masave përkatëse në përputhje me standardin ISO 27002:2022, gjithashtu dhe referuar rekomandimeve të mëparshme nga DG Agri. Më tej MBZHR shprehet: *“Propozimet tuaja do të reflektohen në praktikën që do të dërgohet në DAP dhe në Ministrinë e Financave shtesa për 10 pozicione pune”*.

Komunikimet e mëtejshme AZHBR nuk i disponon. Grupi i auditimit konstaton se në strukturën e miratuar në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 93, datë 12.06.2024 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”* ky pozicion nuk është shtuar.

Verifikimi i Politikave dhe Standardeve në TIK

Në këtë nënpikë grupi i auditimit u fokusua në auditimin e dokumentacionit, procedurave dhe manualeve në lidhje me sistemet e informacionit, politikat dhe strategjitë në këtë fushë, vlerësimin e riskut dhe masat e marra në raste incidentesh.

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe në zbatim të Manualit të Procedurave të Incident Response Plan (IRP), ku specifikohet se Grupi i Përgjigjes ndaj Incidenteve (Instant Response Team-IRT) ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR, Titullari ka ngrit grupin e punës të Incident Response Team (IRT) me urdhrin Nr. 479, date 20.09.2022, të përbërë nga: oficeri i riskut, koordinatore të riskut të çdo drejtorie, oficeri i raportimit, oficeri i parregullsisë, oficeri për menaxhimin e burimeve njerëzore, oficeri për monitorimin dhe analizën e ndryshimeve të legjislacionit, oficeri për marrëdhëniet me publikun dhe përgjegjësi i sektorit i arkivit dhe protokollit. IRT është struktura përgjegjëse për reagimin ndaj incidenteve në AZHBR dhe detyra e saj është të propozojë, të implementojë dhe të sigurojë zbatimin e politikave të sigurisë dhe të ndihmojë në mbrojtjen e aseteve të informacionit. Sipas Manualit të Procedurave Incident Response Policy (E-1.0-6.0 v1.0 2023) pjesë e IRT duhet të jetë edhe drejtori i DTI-së.

Raportimet për incidente pranë Drejtorit të Përgjithshëm nuk janë periodike; ato bëhen sipas rastit kur regjistrohen/evidentohen problematika si në rastet e sulmeve kibernetike, problemet me website-t e institucionit etj. Grupi i auditimit e pa me vlerë kqyrjen e procedurës së ndjekur për konstatimin, raportimin dhe masat e marra për mbrojtjen e sistemeve të informacionit gjatë sulmit kibernetik të vitit 2022, për shkak dhe të impaktit të gjerë që ky sulm pati jo vetëm te sistemet e informacioni dhe përdoruesit fundor të tyre, por dhe te ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve nëpërmjet portalit qeveritar.

Kjo procedurë është dokumentuar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) e cila me anë të Memos Nr. 2566/5 prot., datë 09.08.2022, me lëndë: *“Informacion mbi sulmin kibernetik të sistemeve; drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Oficerin e Sigurisë së Informacionit, ka përcjellë:*

1. Procesverbal Konstatimi;
2. Procesverbal për ndjekjen e instruksioneve të marra nga AKSHI;
3. Procesverbal për instalimin e programeve mbrojtëse për sistemet operative;
4. Raporti i Incident Response Plan.

Ndër të tjera DTI sugjeron dhe firmosjen e një marrëveshje bashkëpunimi me AKSHI-n, si autoriteti që ofron shërbime të përqëndruara nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për administratën shtetërore. Grupi i auditimit konstaton se ende nuk ka një marrëveshje bashkëpunimi midis AKSHI dhe AZHBR.

Trajnimet në TIK

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion, si një nga format që ndikon në mënyrë direkte në rritjen e performancës së punonjësve. Të gjithë punonjësit që janë përdorues të sistemeve të informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Procesi duhet të kalojë në një fazë identifikimi dhe analize të nevojave për trajnim të stafit, me qëllim që të sigurohet parashikimi, programimi dhe implementimi i suksesshëm i veprimtarive trajnuese.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, AZHBR nuk ka plan trajnimi vjetor për teknologjinë e informacionit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në kundërshtim me ligjin Nr. 10296 datë 16.09.2016 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 20, pika 2 ç: “Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore”. Në raportet e veta 3, 6, 9 dhe 12 mujore DTI bën sugjerime të përgjithshme për fushat e interesit që drejtorja ka për trajnime.

Grupi i auditimit analizoi materiale excel të vendosura në dispozicion me temat e trajnimit dhe punonjësit që kanë marrë pjesë në secilin prej tyre përgjatë gjithë periudhës së auditimit. Nga materiali i vendosur në dispozicion rezulton se janë zhvilluar: 1 (një) trajnim në 2022 ku ka marrë pjesë vetëm 1 (një) punonjës i drejtorisë, 2 (dy) trajnime në 2023 ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës të drejtorisë, 6 (gjashtë) trajnime në 6 (gjashtë) mujorin e parë të 2024 ku kanë marrë pjesë 5 (pesë) punonjës të drejtorisë.

Strategjia institucionale dhe risqet në fushën e Teknologjisë së Informacionit

Strategjia e institucionit përfshin objektivat strategjik të cilët do të udhëheqin veprimtarinë e institucionit vitet e ardhshme, përfshirë këtu dhe planifikimin strategjik për fushën e teknologjisë së informacionit. Referuar përgjigjeve të pyetësorit “Kërkesë për informacion/dokumentacion për “Auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)” mbi pikën e strategjisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe intervistave me subjektin, institucioni nuk ka një plan strategjik të vetin të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, por zbaton planin strategjik të Ministrisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Nga verifikimet në faqen zyrtare të ministrisë nuk ka një plan strategjik që i përket periudhës së auditimit 01.01.2022-30.06.2024.

Me urdhër titullari, është përcaktuar një koordinator risku për çdo drejtori. Për DTI kordinator risku është Drejtori i Drejtorisë znj. K.H. Koordinator i riskut për DTI drafton çdo 6 (gjashtë) muaj “Raportimin e riskut” që përfshin:

- Objektivat, procedurat dhe risqet për DTI
- Regjistrin e riskut për DTI
- Planin e veprimit dhe menaxhimit të riskut për DTI

Dokumenti i hartuar, i përcillet në mënyrë elektronike dhe shkresore Oficerit të Riskut i cili harton regjistrin e riskut dhe planin e veprimit për institucionin dhe raportohet në institucionet kompetente. (E-9.0-4.1 Processes and the relevant risks for DIT).

Auditi i Brendshëm

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr.81, date 10.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, Sektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) funksionon si njësi e pavarur nga drejtoritë e tjera dhe i raporton direkt Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR. Kjo strukturë e kryen aktivitetin e saj bazuar në ligjin Nr.114, datë 22.10.2025 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave, Nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

Aktualisht bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 93, datë 12.06.2024 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”*, me anë të së cilit është miratuar ristrukturimi i institucionit, Sektori i Auditimit të Brendshëm është ristrukturuar si drejtori me 2 (dy) sektor: Sektori i Auditimit të Brendshëm për IPARD dhe Sektori i Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare.

SAB rezulton të ketë pasur vakanca gjatë gjithë periudhës objekt auditimi, përkatësisht 2 (dy) pozicione vakant në 2022 për funksionin *“Specialist”*, 3 (tre) pozicione vakant në 2023 për funksionin *“Specialist”* dhe 2 (dy) pozicione vakant në gjashtë mujorin e parë të 2024 për funksionin *“Specialist”*. Arsimimi i punonjësve të këtij sektori për periudhën e auditimit ka qenë i profilit ekonomik dhe juridik, pra vihet re mungesa e specialistëve të fushës IT për të realizuar me kompetencë dhe profesionalizëm auditime në fushën e teknologjisë dhe informacionit.

Në 2022 Sektori i Auditimit të Brendshëm zhvilloi auditimin me objekt: *“Audit of Technology and Information System Follow up” Enquiry ITR/2021/001/AL concerning IPARD II program – Audit mission by the Directorate General for Agriculture and Rural Development (DG AGRI) Republic of Albania*”, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve mbi sigurinë e sistemeve të informacionit për periudhën 2021-2022.

Grupi i punës për këtë auditim përbëhej nga Znj. M.G, Znj. E.S dhe Znj. Sh.I, asnjë prej tyre nuk ka profilizim në fushën e TIK. Në zbatim të *“Manualit të auditimit të brendshëm”* miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, në pikën *“2.4.4 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit”* shprehet qartësisht se: *“Për shkak të natyrës së kësaj fushe, audituesi i brendshëm duhet të ketë njohuri specifike të teknologjisë së informacionit dhe të gëzojë ekspertizën e nevojshme në kryerjen e këtij lloji auditimi”*.

Për vitin 2023, plani fillestar vjetor i auditimit i miratuar Nr. prot 3428/1 , datë 11.10.2022 parashikonte gjithsej 8 (tetë) misione auditimi, pjesë e të cilave ishte dhe auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit. AZHBR shprehet se bazuar në volumin e madh të dokumentacionit të dosjeve për auditim, burimeve njerëzore në dispozicion të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në AZHBR për shkaqe objektive, u pa i nevojshëm ndryshimi i planit të auditimit dhe se për vitin 2024 fusha prioritare ku do të mbështetet veprimtaria e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm janë sistemet e TIK.

Për vitin 2024, në përputhje me planin vjetor të auditimit Nr. prot. 3146/2, datë 09.10.2023, janë parashikuar 8 (tetë) misione auditimi nga të cilat: 3 (tre) auditime financiare, 3 (tre) përputhshmërie, 1 (një) kombinuar sipas nevojës dhe 1 (një) i teknologjisë së informacionit. Me anë të memos Nr. 2024 prot., datë 19.07.2024, me lëndë: *“Rishikim i planit vjetor të auditimit për vitin 2024”*, konceptuar dhe miratuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, drejtuar Titullarit të Institucionit, paraqitet për miratim plani i rishikuar për auditimet e planifikuara në 2024. Njësia e auditimit të brendshëm pasi është vënë në dijeni me anë të memos Nr.1917, datë 15.07.2024 mbi ankesat e aplikantëve të programit IPARD II, lidhur me refuzimin e kërkesave për pagesë/zbritjen e kontributit publik të aprovuar për pagesë, shprehet se konstaton mangësi potenciale në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe shikon si të domosdoshëm kryerjen e një vlerësimi më të hollësishëm nëpërmjet një angazhimi auditimi tematik për të adresuar situatën. Për shkak të ndjeshmërisë së kësaj problematike, është vlerësuar e arsyeshme nga institucioni që auditimi i planifikuar për sistemet e teknologjisë së informacionit në 2024, të zëvendësohet me auditim tematik me temë: *“Sistemi i trajtimit të ankesave dhe procedurave perjashtimore 13,14,15,16,17”*.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm, u konstatua se:

1. Kjo strukturë nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 8 dhe 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.

2. Në strukturë mungojnë ekspertët e fushës TIK në kundërshtim me “Manualin e auditimit të brendshëm” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, pika “2.4.4 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit”, ku citohet se: “Për shkak të natyrës së kësaj fushe, audituesi i brendshëm duhet të ketë njohuri specifike të teknologjisë së informacionit dhe të gëzojë ekspertizën e nevojshme në kryerjen e këtij lloji auditimi”.

3. Nuk janë zhvilluar burimet njerëzore me njohuri për auditimin e TI-së në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4. pika 6, nenit 9 dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm në fushën TIK për periudhën objekt auditimi, u konstatua se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm:

- Nuk ka si pjesë të strukturës auditues me profil IT;
- Nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit (vetëm programi për zbatimin e rekomandimeve për programin IPARD II zhvilluar në 2022);
- Nuk ka zhvilluar burimet njerëzore me njohuri për auditimin e TI-s.

Për sa është trajtuar në këtë drejtim të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione për Projekt Raportin.

2.2 Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

Në zbatim të pikës 2.1 të Programit të Auditimit janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër procedurat e investimeve në fushën e TIK.

Për periudhën objekt auditimi 2022-2024 Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka realizuar rreth 12 procedura prokurimi për teknologjinë e informacionit, me vlerë 8,811,322 lekë pa TVSH dhe 10,573,586 lekë me TVSH. Përkatësisht, për vitin 2022 janë realizuar rreth 5 procedura prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 3,531,742 lekë pa TVSH të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2 Regjistri i realizimeve i AZHBR për vitin 2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Fondi i përllogaritur	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
1	Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare	Shërbime	980,000.00	899,000.00	1,078,800.00
2	Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al	Shërbime	395,000.00	210,000.00	252,000.00
3	Shpenzime për mirëmbajtje rrjeti informatik dhe telefonik VOIP	Shërbime	924,000.00	644,000.00	772,800.00

4	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK	Shërbime	995,000.00	845,742.00	1,014,890.00
5	Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD	Shërbime	970,000.00	933,000.00	1,119,600.00

Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Punoi: Grupi i Auditimit

❖ Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2022”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 56, datë 15.02.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 980,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 899,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 81,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 17.02.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 2 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 729/3 prot., datë 24.02.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,078,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 10 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 650/5 prot., më datë 22.02.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën tre oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “O.H” me vlerë 888,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;
2. Operatori Ekonomik “E.” me vlerë 569,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;
3. Operatori Ekonomik “A.Gj” me vlerë 899,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

OE “A.Gj” u shpall fitues pasi OE “E.” nuk u paraqit pranë Autoritetit Kontraktor.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 973/1 prot., datë 29.03.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga S.H, A.K dhe A.P kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 650/2 prot., datë 15.02.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 56, datë 15.02.2022 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2022” me fond limit në vlerën 395,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësisia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 650/5 prot., më datë 22.02.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën tre oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “O.H” me vlerë 888,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u skualifikua;

2. Operatori Ekonomik “E.” me vlerë 569,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua;

3. Operatori Ekonomik “A.Gj” me vlerë 899,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u kualifikua.

OE “A.Gj” u shpall fitues pasi OE “E.” nuk u paraqit pranë Autoritetit Kontraktor.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik “A.Gj” kanë nënshkruar kontratën nr. 729/3 prot., datë 24.02.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2022” me vlerë 899,000 lekë pa TVSH dhe 1,078,800 lekë me TVSH.

- Afati i kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve është 10 muaj, në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i cili parashikon se çdo institucion i cili ka një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbim për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim dhe shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike duhet të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Bazuar në pikën 2/b të këtij Vendimi përcaktohet se, institucionet të cilat kanë sisteme ekzistuese duhet të parashikojnë këtë marrëveshje për mirëmbajtjen e sistemeve dhe kohëzgjatja e saj nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

- Neni 7.2 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdher për grupin e monitorimit.

- Urdhri nr. 84, datë 03.03.2022 i miratuar nga titullari i institucionit ka përcaktuar komisionin e përbërë nga S.H, A.K dhe A.P për marrjen në dorëzim të shërbimit.

- Me shkresën nr. 973/1 prot., datë 29.03.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga S.H, A.K dhe A.P kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ *Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2022”*

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 130, datë 05.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 395,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 210,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 185,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 07.04.2022		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 18 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1357/3 prot., datë 21.04.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 252,000 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1322/4 prot., më datë 19.04.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 18 oferta ekonomike ku fitues u shpall Operatori Ekonomik “I.” i renditur i pari me ofertë 210,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1764/1 prot., datë 22.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe E.H kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1322/1 prot., datë 05.04.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 130, datë 05.04.2022 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2022” me fond limit në vlerën 395,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1322/4 prot., më datë 19.04.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 18 oferta ekonomike ku fitues u shpall Operatori Ekonomik “I.” i renditur i pari me ofertë 210,000 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik “I.” kanë nënshkruar kontratën nr. 1357/3 prot., datë 21.04.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2022” me vlerë 210,000 lekë pa TVSH dhe 252,000 lekë me TVSH.

- Neni 5.1 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. Ndërsa në nenin 5.3 përcaktohet krijimi i grupit të marrjes në dorëzim i cili firmos faturën dhe është përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me shërbimin e kërkuar nga porositësi. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 1764/1 prot., datë 22.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe E.H kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2022”**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 131, datë 05.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H. M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 924,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 644,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 280,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 07.04.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
1. Ankimime: AK- ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1439/1 prot., datë 29.04.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 772,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1323/4 prot., më datë 27.04.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku fitues u shpall Operatori Ekonomik “I.” i renditur i dyti me ofertë 644,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 4594/1 prot., datë 13.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i

përbërë nga A.A, A.F dhe A.H kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1323/1 prot., datë 05.04.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 131, datë 05.04.2022 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2022” me fond limit në vlerën 924,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- AK ka pezulluar procedurën e prokurimit me Urdhrin nr. 149, datë 14.04.2022 për shkak se Operatori Ekonomik “O.T.” ka paraqitur një ankesë në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Me shkresën nr. 1494 prot., datë 15.04.2022 AK ka sqaruar se OE “O.T.” është renditur i pari por për shkak të mosdorëzimit të dokumentacionit të plotë është skualifikuar.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1323/4 prot., më datë 27.04.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku fitues u shpall Operatori Ekonomik “I.” i renditur i dyti me ofertë 644,000 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik “I.” kanë nënshkruar kontratën nr. 1439/1 prot., datë 29.04.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2022” me vlerë 644,000 lekë pa TVSH dhe 772,800 lekë me TVSH.

- Neni 5.1 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. Ndërsa në nenin 5.3 përcaktohet krijimi i grupit të marrjes në dorëzim i cili firmos faturën dhe është përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me shërbimin e kërkuar nga porositësi. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 4594/1 prot., datë 13.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe A.H kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2022”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 95, datë 16.03.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 995,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 845,742 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 149,258 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 25.03.2022		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 4 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 3 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1103/5 prot., datë 11.04.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,014,890 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1103/4 prot., më datë 04.04.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 4 oferta ekonomike ndër të cilat KVO refuzoi në Sistemin e Prokurimit Elektronik OE “G.Xh” me ofertë ekonomike në vlerën 845,000 lekë pa TVSH për shkak se objekti i veprimtarisë nuk përputhej me objektin e prokurimit. OE i renditur i pari “O.T” me ofertë në vlerën 833,333 lekë pa TVSH dhe OE i renditur i dyti “I.S.T” me ofertë në vlerën 834,870 lekë pa TVSH u tërhoqën nga procedura pas njoftimit në sistemin e prokurimit. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik “I.S” i renditur i treti me ofertë në vlerën 845,742 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me nr. 1103/6 prot., datë 12.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga K.H, A.F dhe A.K kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1103/1 prot., datë 16.03.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 95, datë 16.03.2022 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2022” me fond limit në vlerën 995,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1103/4 prot., më datë 04.04.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 4 oferta ekonomike ndër të cilat KVO refuzoi në Sistemin e Prokurimit Elektronik OE “G.Xh” me ofertë ekonomike në vlerën 845,000 lekë pa TVSH për shkak se objekti i veprimtarisë nuk përputhej me objektin e prokurimit. OE i renditur i pari “O.T” me ofertë në vlerën 833,333 lekë pa TVSH dhe OE i renditur i dyti “I.” me ofertë në vlerën 834,870 lekë pa TVSH u tërhoqën nga procedura pas njoftimit në sistemin e prokurimit. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik “I.S” i renditur i treti me ofertë në vlerën 845,742 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik “I.S” kanë nënshkruar kontratën nr. 1103/5 prot., datë 11.04.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2022” me vlerë 845,742 lekë pa TVSH dhe 1,014,890 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 1103/6 prot., datë 12.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga K.H, A.F dhe A.K kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2022”**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 51, datë 10.02.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H. M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 970,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 933,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 37,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 15.02.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 729/2 prot., datë 23.02.2022	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,119,600 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 10 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 606/4 prot., më datë 17.02.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari “O.T” me ofertë në vlerën 900,000 lekë pa TVSH u tërhoq nga procedura pas njoftimit në sistemin e prokurimit. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik “A.Gj” i renditur i dyti me ofertë në vlerën 933,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 972/1 prot., datë 29.03.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga D.T, A.Ç dhe A.P kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 606/1 prot., datë 10.02.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 51, datë 10.02.2022 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2022” me fond limit në vlerën 970,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H. M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 606/4 prot., më datë 17.02.2022 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari “O.T” me ofertë në vlerën 900,000 lekë pa TVSH u tërhoq

nga procedura pas njoftimit në sistemin e prokurimit. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik “A.Gj” i renditur i dyti me ofertë në vlerën 933,000 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik “A.Gj” kanë nënshkruar kontratën nr. 729/2 prot., datë 23.02.2022 për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2022” me vlerë 933,000 lekë pa TVSH dhe 1,119,600 lekë me TVSH.

- Afati i kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve është 10 muaj, në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i cili parashikon se çdo institucion i cili ka një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbim për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim dhe shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike duhet të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Bazuar në pikën 2/b të këtij Vendimi përcaktohet se, institucionet të cilat kanë sisteme ekzistuese duhet të parashikojnë këtë marrëveshje për mirëmbajtjen e sistemeve dhe kohëzgjatja e saj nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

- Neni 7.2 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 972/1 prot., datë 29.03.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga D.T, A.Ç dhe A.P kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

Për vitin 2023, janë realizuar rreth 6 procedura prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 4,440,600 lekë pa TVSH. Për 6 mujorin e parë të vitit 2024 është realizuar një procedurë prokurimi me vlerë 838,980 lekë pa TVSH. Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim në total 12 dosje të procedurave të prokurimit publik, në tabelën më poshtë janë të pasqyruara përkatësisht viti 2023-2024:

Tabela nr.3 Regjistri i realizimeve i AZHBR për vitin 2023

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Fondi i përllogaritur	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
1	Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare	Shërbime	967,000.00	874,500.00	1,049,400.00
2	Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al	Shërbime	720,000.00	400,000.00	480,000.00
3	Shpenzime për mirëmbajtje rrjeti informatik dhe telefonik VOIP	Shërbime	924,000.00	679,000.00	814,800.00

4	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK	Shërbime	996,500.00	839,100.00	1,006,920.00
5	Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD	Shërbime	995,000.00	874,000.00	1,048,800.00
6	Blerje pajisje TIK	Mallra	968,666.00	774,000.00	928,800.00

Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Punoi: Grupi i Auditimit

Tabela nr.4 Regjistri i realizimeve i AZHBR për vitin 2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Fondi i përllogaritur	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
1	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK	Shërbime	986,744.4	838,980.00	1,006,776.00

Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Punoi: Grupi i Auditimit

❖ Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2023”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2023		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 120, datë 07.03.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve: Tenderit: Z. H. M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 967,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 874,500 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 92,500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 09.03.2023		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 998 prot., datë 20.03.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,049,400 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 9 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 874/4 prot., më datë 16.03.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për

të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari "I." me ofertë në vlerën 750,000 lekë pa TVSH nuk u paraqit në AK pas njoftimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik "A.Gj" PF i renditur i dyti me ofertë në vlerën 874,500 lekë pa TVSH.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 1343/1 prot., datë 18.04.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga S.H, A.K dhe A.P kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 874/1 prot., datë 07.03.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 120, datë 07.03.2023 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt "Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2023" me fond limit në vlerën 967,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 874/4 prot., më datë 16.03.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari "I." me ofertë në vlerën 750,000 lekë pa TVSH nuk u paraqit në AK pas njoftimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik "A.Gj" i renditur i dyti me ofertë në vlerën 874,500 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik "A.Gj" PF kanë nënshkruar kontratën e shërbimit nr. 998 prot., datë 20.03.2023 për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare për vitin 2023" me vlerë 874,500 lekë pa TVSH dhe 1,049,400 lekë me TVSH.

- Afati i kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve është 9 muaj, në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.8.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" i cili parashikon se çdo institucion i cili ka një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbim për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim dhe shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike duhet të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Bazuar në pikën 2/b të këtij Vendimi përcaktohet se, institucionet të cilat kanë sisteme ekzistuese duhet të parashikojnë këtë marrëveshje për mirëmbajtjen e sistemeve dhe kohëzgjatja e saj nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

- Neni 7.2 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 1343/1 prot., datë 18.04.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga S.H, A.K dhe A.P kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ Procedura e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2023"

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2023

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1004/1, datë 20.03.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M
--	--------------------------------------	--

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë me vlerë të vogël"	Z. H. M Znj. S.B Znj. E.Xh	Znj. S.B Znj. E.Xh
5. Fondi Limit (pa TVSH) 720,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 400,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 320,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 20.03.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) Skualifikuar: 4 OE c) Kualifikuar: 1 OE
1. Ankimime: AK- s'ka APP- s'ka KPP -s'ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1199 prot., datë 07.04.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 480,000 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1004/4 prot., më datë 07.04.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 5 oferta ekonomike ku OE "A.Q" me ofertë në vlerën 350,000 lekë pa TVSH, OE "M." me ofertë në vlerën 360,001 lekë pa TVSH dhe OE "S.S" me ofertë në vlerën 329,222 lekë pa TVSH u skualifikuan bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 15/c pasi kanë dhënë oferta më të ulta se 50% e fondit limit. Ndërsa OE "A." me ofertë në vlerën 410,000 lekë pa TVSH është skualifikuar pasi sipas pikës 15/a nuk ka si objekt të veprimtarisë objektin e prokurimit. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik "I." i renditur i pari me ofertë në vlerën 400,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1199/8 prot., datë 22.12.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe A.Sh kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1004/1 prot., datë 20.03.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 181, datë 20.03.2023 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt "Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe [IPARD ipard.gov.al](http://IPARD.ipard.gov.al) për vitin 2023" me fond limit në vlerën 720,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1004/4 prot., më datë 07.04.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 5 oferta ekonomike ku OE "A.Q" me ofertë në vlerën 350,000 lekë pa TVSH, OE "M." me ofertë në vlerën 360,001 lekë pa TVSH dhe OE "S.S" me ofertë në vlerën 329,222 lekë pa TVSH u skualifikuan bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 15/c pasi kanë dhënë oferta më

të ulta se 50% e fondit limit. Ndërsa OE "A." me ofertë në vlerën 410,000 lekë pa TVSH është skualifikuar pasi sipas pikës 15/a nuk ka si objekt të veprimitarisë objektin e prokurimit. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik "I." i renditur i pari me ofertë në vlerën 400,000 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik "I." kanë nënshkruar kontratën e furnizimit nr. 1199 prot., datë 07.04.2023 për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtje e faqes web www.abzhr.gov.al dhe IPARD ipard.gov.al për vitin 2023" me vlerë 400,000 lekë pa TVSH dhe 480,000 lekë me TVSH.

- Neni 5.1 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. Ndërsa në nenin 5.3 përcaktohet krijimi i grupit të marrjes në dorëzim i cili firmos faturën dhe është përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me shërbimin e kërkuar nga porositësi. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 1199/8 prot., datë 22.12.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe A.Sh kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2023"**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2023		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 286, datë 19.04.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë me vlerë të vogël"		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 924,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 679,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 245,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 25.04.2023		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 4 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 2 OE
1. Ankimime: AK- s'ka APP- s'ka KPP -s'ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1438/5 prot., datë 12.05.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 814,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 7 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në

dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- **Përzgjedhja e operatorit fitues:** Operatori Ekonomik "I." me vlerë 679,000 lekë pa TVSH, i cili u njoftua nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit u shpall fitues.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 4001 prot., datë 19.12.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.H, A.Sh dhe A.K kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1938/1 prot., datë 19.04.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 286, datë 19.04.2023 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt "Shpenzime për mirëmbajtje rrjetit informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2023" me fond limit në vlerën 924,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësisia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1938/4 prot., më datë 08.05.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 4 oferta ekonomike:

1. Operatori Ekonomik "F." me vlerë 780,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u refuzua bazuar në pikën 15/a të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" nuk ka si objekt të veprimtarisë objektin e prokurimit;

2. Operatori Ekonomik "J." me vlerë 875,000 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u refuzua bazuar në pikën 15/a të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" nuk ka si objekt të veprimtarisë objektin e prokurimit;

3. Operatori Ekonomik "S." me vlerë 658,333 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik u tërhoq nga procedura e prokurimit;

4. Operatori Ekonomik "I." me vlerë 679,000 lekë pa TVSH, i cili u njoftua nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit u shpall fitues.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik "I." kanë nënshkruar kontratën e shërbimit nr. 1438/1 prot., datë 12.05.2023 për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtje rrjeti informatik dhe telefonik VOIP për vitin 2023" me vlerë 679,000 lekë pa TVSH dhe 814,800 lekë me TVSH.

- Neni 5.1 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. Ndërsa në nenin 5.3 përcaktohet krijimi i grupit të marrjes në dorëzim i cili firmos faturën dhe është përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me shërbimin e kërkuar nga porositësi. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdher për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 4001 prot., datë 19.12.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.H, A.Sh dhe A.K kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ ***Procedura e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2023"***

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2023		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 180, datë 20.03.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 996,500 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 839,100 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 157,400 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 29.03.2023		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 6 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 4 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1374 prot., datë 14.04.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,006,920 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Operatori Ekonomik “I.” me vlerë 839,100 lekë pa TVSH, i cili u njoftua nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit u shpall fitues.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 4000 prot., datë 19.12.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.H, A.F dhe A.K kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1003/1 prot., datë 20.03.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 180, datë 20.03.2023 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2023” me fond limit në vlerën 996,500 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E. Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1003/4 prot., më datë 12.04.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 6 oferta ekonomike:

1. Operatori Ekonomik “A.” me vlerë 498,250 lekë pa TVSH, e cila pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO u refuzua bazuar në pikën 15/c të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” ka dhënë ofertë më të ulët se fondi limit;

2. Operatori Ekonomik “R.” me vlerë 656,000 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk u paraqit pranë AK;

3. Operatori Ekonomik “O.T” me vlerë 658,333 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk u paraqit pranë AK;

4. Operatori Ekonomik "A.D" me vlerë 833,333 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik u tërhoq nga procedura e prokurimit;
5. Operatori Ekonomik "C." me vlerë 835,000 lekë pa TVSH, i cili u njoftua nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se nuk plotësonte një nga kushtet e ftesës për ofertë dhe u skuafikua;
6. Operatori Ekonomik "I." me vlerë 839,100 lekë pa TVSH, i cili u njoftua nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit u shpall fitues.
- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik "I." kanë nënshkruar kontratën e shërbimit nr. 1374 prot., datë 14.04.2023 për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2023" me vlerë 839,100 lekë pa TVSH dhe 1,006,920 lekë me TVSH.
 - Me shkresën nr. 4000 prot., datë 19.12.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga A.H, A.F dhe A.K kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.
 - Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt "Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2023"**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2023		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 281, datë 18.04.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë me vlerë të vogël"		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 995,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 874,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 121,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 25.04.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 2 OE
1. Ankimime: AK- s'ka APP- s'ka KPP -s'ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1409/5 prot., datë 15.05.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,048,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 7 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- **Përzgjedhja e operatorit fitues:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1409/4 prot., më datë 08.05.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 3 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari "I." me ofertë në vlerën 790,000 lekë pa TVSH u tërhoq nga procedura pas njoftimit në sistemin e prokurimit ndërsa OE i renditur i dyti "F.E" me ofertë në vlerën 842,500 lekë pa TVSH u skualifikua pasi nuk ka përmbushur kriterin e shërbimit të ngjashëm sipas kushteve në ftesën për ofertë. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik "A.Gj" i renditur i treti me ofertë në vlerën 874,000 lekë pa TVSH.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 1409/9 prot., datë 22.06.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga K.H, P.P dhe A.A kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1409/1 prot., datë 18.04.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 281, datë 18.04.2023 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt "Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2023" me fond limit në vlerën 995,000 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S. B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1409/4 prot., më datë 08.05.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 3 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari "I." me ofertë në vlerën 790,000 lekë pa TVSH u tërhoq nga procedura pas njoftimit në sistemin e prokurimit ndërsa OE i renditur i dyti "F.E" me ofertë në vlerën 842,500 lekë pa TVSH u skualifikua pasi nuk ka përmbushur kriterin e shërbimit të ngjashëm sipas kushteve në ftesën për ofertë. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik "A.Gj" i renditur i treti me ofertë në vlerën 874,000 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik "A.Gj" kanë nënshkruar kontratën e shërbimit nr. 1409/5 prot., datë 15.05.2023 për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për zhvillim dhe mirëmbajtje Softi IPARD për vitin 2023" me vlerë 874,000 lekë pa TVSH dhe 1,048,800 lekë me TVSH.

- Afati i kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve është 8 muaj, në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.8.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" i cili parashikon se çdo institucion i cili ka një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbim për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim dhe shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike duhet të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Bazuar në pikën 2/b të këtij Vendimi përcaktohet se, institucionet të cilat kanë sisteme ekzistuese duhet të parashikojnë këtë marrëveshje për mirëmbajtjen e sistemeve dhe kohëzgjatja e saj nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

- Neni 7.2 i kontratës në detyrimet e porositësit, parashikon se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. AZHBR ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupin e monitorimit.

- Me shkresën nr. 1409/9 prot., datë 22.06.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, ku komisioni i përbërë nga K.H, P.P dhe A.A kanë kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje TIK”**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje pajisje TIK		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 134, datë 16.03.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 968,666 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 774,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 194,666 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 28.03.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1157 prot., datë 04.04.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 928,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: Menjëherë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 938/4 prot., më datë 04.04.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari “E.K” me ofertë në vlerën 889,990 lekë pa TVSH u skualifikua bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 15/b pasi në një procedurë të mëparshme nuk ka respektuar afatet e vendosura nga AK. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik “K.” i renditur i pari me ofertë në vlerën 774,000 lekë pa TVSH.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 998/1 prot., datë 14.04.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të pajisjeve, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe A.H kanë kryer verifikimin e mallit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 938/1 prot., datë 16.03.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 134, datë 16.03.2023 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt “Blerje pajisje TIK” me fond limit në vlerën 968,666 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 938/4 prot., më datë 04.04.2023 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 2 oferta ekonomike ku OE i renditur i pari “E.K” me ofertë në vlerën 889,990 lekë pa TVSH u skualifikua bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 15/b pasi në një procedurë të

mëparshme nuk ka respektuar afatet e vendosura nga AK. KVO shpalli fitues Operatorin Ekonomik “K.” i renditur i pari me ofertë në vlerën 774,000 lekë pa TVSH.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik “K.” kanë nënshkruar kontratën e furnizimit nr. 1157 prot., datë 04.04.2023 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje TIK” me vlerë 774,000 lekë pa TVSH dhe 928,800 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 998/1 prot., datë 02.05.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të pajisjeve, ku komisioni i përbërë nga A.A, A.F dhe A.H kanë kryer verifikimin e mallit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike.

- Bazuar në nenin 3 të kontratës të lidhur ndërmjet palëve furnizimi i mallit do të realizohej menjëherë me nënshkrimin e kontratës por janë dorëzuar 27 ditë me vonesë dhe në këtë rast Autoriteti Kontraktor duhet të mbante një tarifë ditore prej 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do llogaritet minimalisht mbi 25% e vlerës së kontratës e përcaktuar në nenin 7 të kontratës. AZHBR ka kryer pagesën e plotë dhe nuk ka mbajtur asnjë penalitet mbi vonesën e dorëzimit të pajisjeve e cila është në vlerën 52,245 lekë pa TVSH.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se, për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

❖ **Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2024”**

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 184, datë 29.04.2024	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. H.M Znj. S.B Znj. E.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 986,744.4 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 838,980 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 147,764.4 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 02.05.2024		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 7 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 7 OE
1. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 838/6 prot., datë 28.5.2024	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 1,006,776 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- **Përzgjedhja e operatorit fitues:** Operatori Ekonomik i renditur i treti "I." me vlerë 838,980 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit u shpall fitues.

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:** Me shkresën nr. 2602 prot., datë 16.09.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, nga A.H i cili ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës, për të cilën është kryer pagesa me vlerën 952,776 lekë me TVSH.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 838/1 prot., datë 29.04.2024 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 184, datë 29.04.2024 nga Titullari i institucionit. Urdhri i prokurimit ka si objekt "Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2024" me fond limit në vlerën 986,744.4 lekë pa TVSH. Për zbatimin e Urdhrit është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga H.M, S.B dhe E.Xh.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 838/5 prot., më datë 20.05.2024 ka mbajtur një procesverbal vlerësimi mbi zhvillimin e tenderit për të cilin u paraqitën 7 oferta ekonomike:

1. Operatori Ekonomik i renditur i pari "F.E" me vlerë 743,000 lekë pa TVSH, i cili pas shqyrtimit u njoftua në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit rezultoi se kishte mangësi në dokumentacion;

2. Operatori Ekonomik i renditur i dyti "I.S." me vlerë 778,480 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik u tërhoq nga procedura e prokurimit;

3. Operatori Ekonomik i renditur i treti "I." me vlerë 838,980 lekë pa TVSH, i cili pas njoftimit nga KVO në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit u shpall fitues.

- Agjencia për Zhvillim Rural dhe Bujqësor dhe Operatori Ekonomik "I." kanë nënshkruar kontratën e shërbimit nr. 838/6 prot., datë 28.5.2024 për procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2024" me vlerë 838,980 lekë pa TVSH dhe 1,006,776 lekë me TVSH.

- Me shkresën nr. 2602 prot., datë 16.09.2023 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, nga A.H i cili ka kryer verifikimin e shërbimit i cili ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës, për të cilën është kryer pagesa me vlerën 952,776 lekë me TVSH. Marrja në dorëzim duhet të kryhet nga një grup me 3 ose më shumë persona, ku të paktën një anëtar të jetë specialist i fushës. Institucioni në grupet e marrjes në dorëzim, grupet e monitorimit si dhe në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrë në konsideratë caktimin e personave me kualifikimet dhe njohuritë e nevojshme me qëllim mirë përdorimin e fondeve, sidomos në procedurat e prokurimit në fushën e teknologjisë së informacionit duke marrë parasysh shërbimin që ofron.

Për sa është trajtuar në këtë drejtim të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione për Projekt Raportin.

2.3 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemet informatike mbi të dhënat Input/Output si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre si:

- Përshkrim i përgjithshëm i sistemit të teknologjisë së informacionit në AZHBR;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;
- Aksesimi i sistemit me përdorues me të drejta "lexues";
- Aktet rregullative që lidhen me sistemet;
- Informacion mbi veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Manuallet e përdorimit të sistemeve;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara;
- Vizita në terren;
- Indikatorë dhe statistika, etj.

AZHBR është institucioni përgjegjës si strukturë operative për zbatimin e asistencës financiare të BE për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural” (IPARD). Gjithashtu AZHBR është institucioni përgjegjës për administrimin e fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural e implementimin e Skemave Mbështetëse Kombëtare.

Për periudhën objekt auditimit, gjatë vitit 2022 AZHBR ka pasur në përdorim sistemet: Sistemin e Menaxhimit të Informacionit IPARD II (SMI IPARD II), Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Skemat Kombëtare (SMI Skemat Kombëtare) dhe Sistemin PRDB, konkretisht:

➤ Administrimi i zbatimit të programit IPARD II (SMI IPARD II) është realizuar nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për programin IPARD II, funksionalitetet dhe modulet e të cilit janë përshtatur sipas Programit të Zhvillimit Rural 2014 – 2020 i Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA) për Shqipërinë. Funkzioni i këtij sistemi ishte menaxhimi i aplikimeve për përfitim nga grantet që janë dhënë në kuadër të implementimit të projektit IPARD II 2014 – 2020 për thirrjen e parë, thirrjen e dytë, thirrjen e tretë, thirrjen e katërt dhe në kuadër të implementimit të projektit IPARD II për thirrjet e reja (nëse do të kishte). Ky sistem është zhvilluar nga GIZ - Projekti për Zhvillimin Ekonomik dhe Promovimin e Punësimit në Bujqësi (EDEP)”, si financues dhe krijues i këtij sistemi, i cili ka përfunduar implementimin në 21 dhjetor të vitit 2016 dhe i është dorëzuar AZHBR-së për administrim dhe përdorim.

Nga auditimi konstatohet se sistemi IPARD II aktualisht shërben vetëm si një arkivë elektronike për dosjet e aplikimeve dhe nuk përdoret më për realizimin e aplikimeve për fermerët. Gjithashtu për një periudhë 1 vjeçare sistemi është pa mirëmbajtje dhe suport që nga periudha kur ka përfunduar kontrata e mirëmbajtjes.

Nga komunikimet me personat e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit konstatohet se janë bërë back up materialet sipas mundësive në usb, disk etj. Në kushtet aktuale që ndodhet ky sistem dhe mënyra sesi menaxhohet, rrezikon ndërprerjen duke e bërë të pamundur rikthimin e sistemit në gjendjen fillestare me bazën e të dhënave që ruhet në sistem.

➤ Administrimi i Skemave Kombëtare deri në vitin 2023 është realizuar nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare (SMI Skemat Kombëtare), funksionalitetet dhe modulet e të cilit përshtaten për çdo vit me VKM dhe Udhëzimin përkatës *“Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”*.

Sistemi elektronik i implementuar që në vitin 2012, ka realizuar menaxhimin e informacionit për aplikimet e bëra me qëllim përfitimin nga skemat e subvencioneve që mbështet AZHBR në përputhje me VKM-në dhe Udhëzimin përkatës që publikohen çdo vit. Sistemi ka qënë dhuratë për AZHBR si pjesë e një projekti në grup.

Në SMI Skemat Kombëtare që prej vitit 2018 deri në vitin 2023, aplikimi për përfitim nga skemat kombëtare të mbështetjes së fermerëve është realizuar online përmes portalit e-Albania. Aplikimet e bëra për këtë shërbim elektronik në portalin e-Albania janë postuar tek dhe janë trajtuar më pas nëpërmjet sistemit SMI Skemat Kombëtare.

Çdo vit në bazë të VKM dhe Udhëzimeve përkatëse, masat mbështetëse kanë qënë të ndryshme dhe sistemi për çdo rast (masë Mbështetëse) ka realizuar mbledhjen, përlllogaritjen e vlerës së përfitimit dhe reflektimit të kufizimeve.

Nga auditimi konstatohet se sistemi SMI Skemat Kombëtare për shkak të mangësisë në kapacitete, nuk përdoret më për aplikimet dhe shërben si arkivë elektronike për nxjerrjen e informacioneve për aplikimet e realizuara ndër vite. Gjithashtu konstatohet se AZHBR nuk ka marrë masa në lidhje me ruajtjen e të dhënave që ky sistem përmban duke riskuar humbjen e informacionit të ruajtur në sistem. Në kushtet aktuale që ndodhet ky sistem dhe mënyra sesi

menaxhohet, rrezikon ndërprerjen duke e bërë të pamundur rikthimin e sistemit në gjendjen fillestare me bazën e të dhënave që ruhet në sistem.

❖ *Sistemet që AZHBR aktualisht ka në përdorim dhe ka investuar për to përgjatë vitit 2023 janë: Sistemi SMI IPARD dhe Sistemi SMI Skemat Kombëtare.*

➤ ***Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Programin IPARD - SMI IPARD***

Zhvillimi i këtij sistemi lindi si nevojë e dixhitalizimit të proceseve të punës, uljes së barrës administrative për fermeret dhe për punonjësit e AZHBR, rritjen e transparencës ndaj aplikantëve dhe rritja e besueshmërisë së plotë për Programin.

Dixhitalizimi përfshin të gjitha hallkat e procesit të punës që nga aplikimi i subjekteve nëpërmjet platformës e-Albania dhe shqyrtimit të aplikimit në back-end e SMI IPARD Online.

Në zbatim të kontratës Nr. 8 prot., datë 16.05.2022 me objekt “Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin IPARD - për AZHBR”, sistemi ekzistues back-end i SMI IPARD është përshtatur me proceset e reja të rrjedhës së të dhënave në sistemin e përmirësuar SMI IPARD Online. Kontrata me Nr. 8 prot., datë 16.05.2022 “Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin IPARD - për AZHBR” është lidhur ndërmjet AKSHI-t (Autoritet Kontraktor) dhe operatorit “A.” me vlerë totale 247,000,000 (dyqind e dyzet e shtatë milion) lekë pa TVSH, me një kohëzgjatje për 9 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje nga nënshkrimi i kontratës.

Sistemi është një sistem i ri i cili aktualisht është funksional dhe pritet të përdoret në momentin që do të hapen thirrjet për Programin IPARD III.

Sistemi IPARD aktual është zhvilluar për aplikimet për thirrjet 1, 3 dhe 7. Gjatë stadeve të procesit aplikimet kalojnë nëpër kontrole të drejtorive të ndryshme dhe në fund të procesit kalojnë ose skualifikohen.

Çdo thirrje IPARD ka ambientin e vet të pavarur nga thirrjet e tjera (database/ instancë DB si dhe forma aplikimit) në mënyrë që ndryshimet procedurale/administrative të jenë të aplikueshme, nga thirrja e rradhës. Thirrjet krijohen fillimisht nga administrator i sistemit dhe më pas nuk mund të modifikohet pas datës së fillimit.

Të dhënat për thirrjen sipas manualit aktual të përdorimit janë: numri IPARD, numri Thirrjes, Sasia totale – sasia konvertimit, EURO dhe LEK, Matjen/Matjet (të dhënat për EUR/LEK), të dhënat – Datë nisje dhe Datë përfundimi.

Hapja e thirrjes përcakton: masat dhe sektorët sipas masave, limitime të mundshme në listen e shpenzimeve të pranueshme etj.

Workflow ekzistues i AZHBR sipas drejtorive DPAP (Drejtoria e e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekeve), DAP (Drejtoria e Autorizimit të Pagesave), DK (Drejtoria e Kontrollit), DEP (Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave) është përshtatur në sistem sipas rrjedhës fizike që kalonte aplikimi në AZHBR. Komunikimi me aplikantin për sa parashikohet në procedurat e AZHBR për fazat në të cilat kalon aplikimi nga shqyrtimi, kontraktimi deri në ekzekutimin e pagesës realizohen nëpërmjet portalit e-Albania.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur rolet dhe përshkrimet e tyre sipas attributeve që kanë në sistem.

Tabela nr.5 Rolet e përdoruesve në sistemin SMI IPARD

Roli	Përshkrimi i attributeve në sistemin SMI IPARD
ADMINISTRATORI	Administratori i aplikimit IPARD suporton përdoruesin, mundësinë për të përcaktuar thirrjen, përditëson kursin e këmbimit dhe përcakton ditët e pushimit në system.
APPLICATION_ADMIN	Ka aftësinë të përditësojë disa vlera në formularin e aplikimit kur merret kërkesa për ndryshim
GENERAL_DIRECTOR	Drejtori i përgjithshëm i AZHBR-ës është pika kryesore e ndërveprimit midis AZHBR dhe Aplikantit: lajmëron aplikantin për përditësimet në


	formularin e aplikimit, dërgon kontratën, merr aplikimet, dokumentat, kontratën e firmosur dhe kërkesat/ankesat nga aplikantët. Të gjitha dokumentat që Drejtori i përgjithshëm i dërgon aplikantëve janë të mbyllura digjitalisht dhe të firmosura.
DPSA_DIRECTOR	Drejtori i Direktoratit/Sektorit për Përzgjedhje dhe Konfirmim
DPSA_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i Sektorit nga Direktorati/Sektori për përzgjedhje dhe konfirmim projekti
DPSA_INSPECTOR	Inspektori nga Direktorati/Sektori për përzgjedhje dhe konfirmim projekti
DPA_DIRECTOR	Drejtori i Direktoratit/Sektorit për konfirmim projekti
DPA_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i sektorit nga Direktorati për Konfirmim Projekti
DPA_INSPECTOR	Inspektori nga Direktorati për Konfirmim Projekti
DC_DIRECTOR	Drejtuesi i Direktoratit për kontroll
DC_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i sektorit nga Direktorati për kontroll
DC_INSPECTOR	Inspektori nga Direktorati për kontroll
DEP_DIRECTOR	Drejtuesi i Direktoratit për Ekzekutim/Zbatim Pageese
SEPI_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i sektorit nga Direktorati për ekzekutim/zbatim pageese
SEPI_INSPECTOR	Inspektori nga Direktorati për Ekzekutim/Zbatim pageese
SDM_DIRECTOR	Drejtuesi i sektorit për Menaxhim Borxhi
SDM_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i Sektorit nga sektori për Menaxhim Borxhi
SDM_INSPECTOR	Inspektori nga Sektori për Menaxhim Borxhi
DBMR_DIRECTOR	Drejtuesi Direktoratit për Databazë dhe Kërkim Tregu
DBMR_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i Sektorit nga Direktorati për Databazë dhe kërkim tregu.
DBMR_INSPECTOR	Inspector from Directorate for DataBase and Market Research
AUDIT	Përdorues i brendshëm, rol vetëm vëzhgues, ata nuk do të ndërhyjnë në aplikimin IPARD, do të mund të shikojnë të gjitha detajet rreth aplikimeve, listat, auditin dhe raportet.
EXT_AUDIT	Përdorues i jashtëm, me rol vetëm vëzhgues, ata nuk mund të ndërhyjnë në aplikim, do të mund të shikojnë detajet e plota për një numër të zgjedhur aplikimesh me lista të pjesshme dhe raporte, nuk do kenë aftësi të nxjerrin të dhëna.
MANAGING_AUTHORITY	Rol vëzhgues, ata nuk mund të bëjnë ndryshime në aplikim, nuk kanë mundësi të shohin detajet e plota, mund të shikojnë vetëm listën e plotë, statuset dhe të gjenerojnë raporte.
SLA_DIRECTOR	Drejtuesi i Sektorit të Çështjeve të ligjshme
SLA_HEAD_OF_SECTOR	Kreu i sektorit nga sektori i Çështjeve të ligjshme
SLA_INSPECTOR	Inspektor nga Sektori i Çështjeve të ligjshme
MONITORING_DIRECTOR	Drejtues i Direktoratit për Monitorim/Vëzhgim
MONITORING_HEAD_OF_SECTOR -	Kreu i sektorit nga Direktorati për Monitorim/Vëzhgim
MONITORING_INSPECTOR	Inspektor nga direktorati për Monitorim/Vëzhgim
E_ALBANIA	Rol sistemi i përdorur nga e-Albania për tu lidhur me aplikimin e IPARD , i fshehur në Aplikacion

Sistemi SMI IPARD merr aplikimet që bëhen nga portal e-Albania, ku çdo aplikim gjeneron numrin unik (ID).

Krijimi i një aplikimi të ri në sistem:

Përdoruesit do kenë mundësi të aplikojnë vetëm gjatë periudhës kur një thirrje është e hapur.


Figura nr.1 Krijimi i aplikimit te ri



Burimi: Sistemi SMI IPARD

Aplikanti fillimisht duhet të zgjedhë Masën dhe Sektorin kryesor për të cilin do të aplikojë dhe më pas plotëson 5 pesë tab-et si në figurat më poshtë:


Figura nr. 2 Tab-et që aplikanti duhet të plotësojë në portal



Burimi: Sistemi SMI IPARD

Aplikanti duhet të plotësojë të gjitha tab-et, fushat dhe dokumentacionet e nevojshme për të kompletuar aplikimin. Gjatë plotësimit, aplikanti specifikonë çdo detaj të nevojshëm dhe hedh dokumentacionin e kërkuar, procedure kjo e cila do të realizohet e gjitha online. Kur aplikanti dorëzon aplikimin, aplikimi kalon në status “Submitted” dhe nuk është më e mundur të modifikohet nga aplikanti. Aplikimi shqet në sistem te drejtoritë përkatëse (Drejtori i Përgjithshëm dhe AZHBR).

Aplikimi në AZHBR:



Vetëm menaxherët e lartë IPARD (drejtorë, përgjegjës sektori) kanë akses në sektorin Aplikime. Inspektorët kanë akses vetëm në sektorin Dashboard ku shfaqen të gjitha aplikimet që ata kanë në ngarkim. Kur zgjidhet menuja Aplikime hapet lista e të gjitha aplikimeve për masat që përdoruesi aktual ka leje të shqyrtojë.

Filtrat për një aplikim janë: ID Aplikimit, Emri Aplikuesit, Data, Masat, i Përcaktuari dhe Statusi. Statusi i Aplikimit mund të jetë: Kërkohen dokumenta shtesë, Dokumentat shtesë janë shtuar, i aprovuar, Duke pritur dokumentat e Aplikuesit, Skualifikuar, Në Procedim, Në process nga Drejtori.

Sistemi SMI IPARD ndërvepron dhe komunikon me regjistrat elektronik të palëve të treta dhe bazave të të dhënave shtetërore, konkretisht me:

- Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për të dhënat e shtetasve shqiptar si: Emri, Mbiemri, Atësia, Vendbanimi, Gjinia, Vendindja, Datëlindja, Mëmësia, Gjendja Civile;
- Regjistrin tregtar dhe Regjistrin e Licensave të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të dhënat që mundësojnë verifikimin e:
 - o nuk është në procedura falimentimi ose likuidimi;
 - o zotërim liçencat për aktivitetin aktual që operon;
 - o regjistrimin e biznesit në QKB;
 - o të liçencës për ushtrimin e veprimtarisë së pranueshme bujqësore në rast se kërkohet nga ligji në fuqi;
 - o të ekstraktit
- Regjistrin e tatimpaguesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për verifikimin e të dhënave:
 - o përmbushjen e detyrimeve të pagesës së taksave për vitin aktual;
 - o të xhiros vjetore të tre viteve të fundit;
 - o përmbushjen e detyrimeve të pagesës së taksave (kontributet shoqërore, shëndetësore për fermerët individual;
- Regjistrin e të siguruarve të ISSH për të dhënat që verifikojnë në rastin e personit fizik ose personit juridik, përfaqësuesi ligjor ose i punësuar si drejtues ka të paktën 3 vite eksperiencë pune në bujqësi;
- Sistemin e Automatizuar të të Dhënave Doganore për të dhënat e deklaratës doganore për mallrat e importuar.

Në zbatim të kontratës Nr. 8 prot., datë 16.05.2022, sipas fazave të zhvillimit të projektit është përcaktuar që projekti do të implementohej duke i'u nënshtuar 5 fazave:

FAZA I: Mbledhja dhe analizimi i kërkesave dhe miratimi i proceseve;
FAZA II: Zhvillimi, duke zhvilluar të gjitha kërkesa dhe përmirësimet e moduleve ekzistuese, ngritja e moduleve të pritjes së aplikimeve nëpërmjet e-Albania;
FAZA III: Testimi dhe trajnimi;
FAZA IV: Marrja në dorëzim e sistemit në të cilën përcaktohet: Pasi të gjitha modulet e sistemi të jenë testuar dhe çdo gjë të jetë në rregull, do bëhet dorëzimi i sistemit;
FAZA V: Mirëmbajtja.

Nga auditimi i raporteve mujor të mirëmbajtjes të sistemit për periudhën 16.06.2023 deri në 18.06.2024 u konstatua se, çdo muaj ka pasur ndryshime/përditësime si në funksionalitetet egzistuese nga marrja në dorëzim e sistemit por edhe ndryshime në module, workflow etj. Konkretisht, u konstatuan raste:

- ndryshime në funksionalitet të reja lidhur me statusin e aplikimit gjatë fazës së shqyrtimit;
- përditësime të vazhdueshme të workflow-t të sistemit;
- kërkesë për ndryshim: “butoni për shfaqjen e planit të biznesit”, funksionalitet i cili aktualisht është i përcaktuar në manualin e përdorimit. Në vijim ky tab është hequr nga ndërfaqja e sistemit;
- janë bërë ri-punime të modulit përkatës për gjenerimin e kontratave;
- përditësime të vazhdueshme të check listave që u shfaqen drejtorive përkatëse që kanë akses në sistem;
- ka sesione të cilat janë zhvilluar sipas specifikimeve të kontratës dhe nuk janë më funksionale ose janë ndryshuar, konkretisht sesioni për përdoruesit me rolin “audit”, për të cilin specifikohet në manualin e përdorimit se kanë akses në sistem me qëllim ndryshimin e hyrjeve të sistemit, konstatohet se ky funksionalitet nuk është më në funksion dhe është ndryshuar duke i lënë këtyre përdoruesve vetëm të drejta View-er në sistem.

Nga auditimi konstatohet se përmirësimi i sistemit SMI IPARD në lidhje me funksionimin, përmirësimin e moduleve ekzistuese, trajtimin dhe procesimin e aplikimeve për të përfituar nga programi IPARD ende nuk e ka arritur qëllimin për informatizimin e të gjitha hapave të procesit nëpërmjet përdorimit të sistemit, si në lidhje me workflow-n ashtu dhe me veprimet operacionale të AZHBR-ës. Kjo situatë sjellë risk në ndërprerjen e shërbimit dhe vazhdimësisë së funksionimit të sistemit në momentin e hapjes së thirrjeve si dhe zhvillimit të të gjithë procesit nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi konstatohet se, manuali i përdorimit të sistemit SMI IPARD nuk është përditësuar sipas versioneve të ndryshimeve të realizuara duke qënë se janë bërë ndryshime dhe përditësime të vazhdueshme në sistem.

Nga ekstrakti mbi userat e sistemit të cilët janë krijuar me qëllim vazhdimësinë e funksionimit të sistemit, konstatohet se aktualisht sistemi SMI IPARD disponon 102 usera, nga të cilët 79 janë aktiv dhe 23 janë inaktiv.

Nga auditimi i userave të hapur në sistem konstatohet se:

- janë hapur usera pa role, konkretisht egzistojnë 29 role në sistem për të cilin roli është bosh dhe nuk i është caktuar asnjë rol specifik në sistem. Ky fakt mbart risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem duke mos lënë mbi aktivitetin që kanë kryer këto përdorues në sistem. Nga këto usera 10 janë aktiv në sistem dhe 19 janë inaktiv;
- egzistojnë role të cilët nuk janë sipas manualit të përdorimit të sistemit, konkretisht roli: Parregullsi, administrator përdoruesi, role të cilët nuk i janë caktuar detyrat në sistem;
- roli “Oficeri i Sigurisë”, është inaktiv, si dhe nuk i është caktuar personit përgjegjës për detyrat e Oficerit të Sigurisë;
- rolet në sistem janë hapur me emërtime të cilat nuk përputhen sipas manualit të përdorimit;

- roli “Edituesit të Aplikimit” të cilët kanë opsionin të ndryshojnë aplikimet për thirrjen dhe masat të përcaktuar në manualin nuk janë funksional;
- egzistojnë role të përcaktuar në manualin e përdorimit për të cilën nuk dihet funksionaliteti për të cilin është krijuar, konkretisht roli E_ALBANIA – rol i sistemit nga e-Albania për tu lidhur me aplikimet IPARD, i fshehur në Aplikacion.

Zgjidhja teknike e sistemit:

Ky sistem dhe gjithë infrastruktura fizike hostohet në datacenterin qeveritar të AKSHI. Pajisjet për kryerjen e backup hostohen në dhomën e serverave në AZHBR, e cila është përshtatur si një backup center për sistemet të cilat janë në përdorim nga AZHBR. Në kontraktën Nr. 8 prot., datë 16.05.2022, përcaktohet se Site Primar i infrastrukturës së sistemit SMI IPARD është në ambientet e Datacenterit Qeveritar, pranë AKSHI, ndërsa site sekondar do të instalohej në një ambient tjetër. Nga auditimi konstatohet se Site Sekondar për sistemin SMI IPARD është vendosur në ambientet e AZHBR, në një largësi gjeografike jo në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, ku kushtet dhe distancën e ndërtimit të një ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë gjithmonë në një pozicion gjeografik që ka risk shumë të ulët që të përfshihet nga një incident apo fatkeqësi natyrore nga ambienti primar, minimalisht 50 km distancë në vijë ajore. Nga auditimi konstatohet se AKSHI ka ownership të këtij sistemi dhe AZHBR është përdorues i sistemit.

➤ ***Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare - SMI Skemat Kombëtare***

Zhvillimi i këtij sistemi lindi si nevojë e dixhitalizimit të proceseve të punës, uljes së barrës administrative për fermerët dhe për punonjësit e AZHBR, rritjen e transparencës ndaj fermerëve dhe rritja e besueshmërisë së plotë për Programin. Dixhitalizimi përfshin të gjitha hallkat e procesit të punës për shqyrtimin e aplikimeve në back-end e SMI Skemat Kombëtare dhe marrja e informacionit në kohë reale.

Në zbatim të kontratës Nr. 48 prot., datë 23.01.2023, me objekt “Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për skemat kombëtare - për AZHBR”, është bërë përmirësimi i sistemit SMI Skemat Kombëtare dhe infrastrukturës së sistemit ekzistues. Kontrata me Nr. 48 prot., datë 23.01.2023 “Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për skemat kombëtare - për AZHBR” është lidhur ndërmjet AKSHI-t (Autoritet Kontraktor) dhe bashkimi i operatorëve “A.” dhe “S.” me vlerë totale 214,518,540 (dyqind e katërmëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë pa TVSH, me një kohëzgjatje për 9 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje nga nënshkrimi i kontratës.

Sistemi është krijuar në përputhje me Maualet e procedurave të AZHBR për Skemën Kombëtare, VKM dhe Udhëzimeve përkatëse që dalin çdo vit në lidhje me Skemat Kombëtare. Sistemi përdor mekanizma autentifikimi single-sign-on, nga platforma që AKSHI disponon. Sistemi është i bazuar në role dhe çdo përdorues ka të drejta vetëm në fushën e tij të përgjegjësisë në ndërfaqen përkatëse që i shfaqet sipas sipas pozicionit të punës dhe funksioneve që ai ka.

Sistemi është realizuar për masat direkte sipas pikës 2 të Vendimit nr. 101, datë 09.02.2022, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022”, pikat a), b), c), ç), d), dh) ndërsa për tre masat e investimit sipas pikës 2 të VKM së sipërcituar, pika e), ë) dhe f).

Për aplikimet e vitit 2024 sistemi është përshtatur sipas pikës 2 të Vendimit nr. 130, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024”, për pikat a), b), c), ç), d), dh), e), gjithashtu janë zhvilluar dhe funksionalitetet për masat e investimeve që do zhvilloheshin në vijim.

Sistemi aktualisht është funksional, me anë të së cilit janë pritur aplikimet për skemat mbështetëse të vitit 2024 në zbatim të Vendimit nr. 130, datë 06.03.2024, si dhe udhëzimit nr. 06, datë 07.03.2024 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financës “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, si dhe Udhëzimit nr. 18, datë 27.06.2024 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financës “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.06, datë 07.03.2024”.

Rolet në sistem sipas kontratës së lidhur janë sipas niveleve të mëposhtme:

- **Nivel Inspektori** – kanë akses në ngarkim-shkarkim të dokumentacionit (skanime, tabela exceli etj), plotësim check-liste;
- **Nivel Përgjegjës Sektori** – kanë akses në ndarjen e dosjeve (caktimi inspektori i I-rë dhe inspektor II-të), shkarkim të dokmumentacionit, miratim check-liste, ngarkim dokumentacioni;
- **Nivel Drejtor Drejtorie** – kanë akses në ndarjen e dosjeve, shkarkim të dokumentacionit, Miratim/Aprovim check-liste;
- **Përdorues audit** – akses në të gjithë historikun e aplikimit/aplikimeve ose në varësi të objektit të auditimit;
- **Përdorues info Aplikimi në Agropika** – akses ne historikun e aplikimeve dhe aksesimin e dokumentave në funksion të plotësimit të Regjistrit të Fermës;
- **Përdorues IT** – akses për të menaxhuar përdoruesit, fjalëkalimet dhe rolet;
- **Drejtor i Përgjithshëm** – akses në të gjithë historikun e aplikimit/aplikimeve.

Niveli i përdoruesve në sistem sipas hapave:

1. Aplikimi në fazën e parë nëpërmjet “e-Albania”, ku të dhënat pas plotësimit nga aplikanti (i cili mund të jetë fermer, person fizik person juridik dhe Shoqërit e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB-të)) nëpërmjet ndërveprimin hidhen në Sistemin SMI skemat Kombëtare.
2. Përdorues në nivel qëndror ku funksionalitetet janë sipas detyrave dhe përgjegjësiqve që ka pozicioni i punës.

Zgjidhja teknike e sistemit:

Pajisjet e sistemit janë të hostuara në ambientet e Datacenterit Qeveritar, pranë AKSHI-it. Serverat e sistemit janë të konfiguruar në cluster me njëri-tjetrin si dhe janë ngritur servera virtual. Konstatohet se, AKSHI ka ownership të ketij sistemi. AZHBR është përdorues i sistemit. Ky sistem dhe infrastruktura fizike hostohet në datacenterin qeveritar të AKSHI.

Sistemi ndërvepron dhe komunikon me regjistrat elektronik te palëve të treta dhe bazave të të dhënave shtetërore, konkretisht me:

- Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për të dhënat e shtetasve shqiptar si: Emri, Mbiemri, Atësia, Vendbanimi, Gjinia, Vendindja, Datëlindja, Mëmësia, Gjendja Civile;
- Regjistrin e tatimpaguesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për verifikimin e të dhënave:
 - o përbushjen e detyrimeve të pagesës së taksave për vitin actual;
 - o të xhiros vjetore të tre viteve të fundit;
 - o përbushjen e detyrimeve të pagesës së taksave (kontributet shoqërore, shëndetësore për fermerët individual;
- Regjistrin e të siguruarve të ISSH për të dhënat që verifikojnë në rastin e personit fizik ose personit juridik, përfaqësuesi ligjor ose i punësuar si drejtues ka të paktën 3 vite eksperiencë pune në bujqësi;

- Sistemin e Automatizuar të të Dhënave Doganore për të dhënat e deklaratës doganore për mallrat e importuar;
- Regjistrin tregtar dhe atë të licensave për të dhënat që mundësojnë verifikimin e:
 - o Përfituesi nuk është në procedura falimentimi ose likuidimi;
 - o Certifikatës nga QKB e cila vërteton se aplikanti zotëron liçencat për aktivitetin aktual që operon;
 - o Certifikatës së regjistrimit në QKB;
 - o Ekstrakti nga QKB;
 - o Liçencës për ushtrimin e veprimtarisë së pranueshme bujqësore (në rast se kërkohet nga ligji në fuqi)
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konkretisht:
 - o Vërtetim që ka tre vite eksperiencë pune në fushën e bujqësisë për investimin që kryen;
 - o Kopje e regjistrimit të kafshëve në sistemin RUDA;
 - o Çertifikatë që fermeri është regjistruar në Regjistrin Rajonal të Fermerëve;
 - o Çertifikatë për mirëqënien e kafshëve RUDA;
 - o Konfirmimin që aplikanti nuk është debitor ndaj AZHBR, MBZHR;
 - o Dokumentin e lejes së peshkimit të anijes.
- Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për:
 - o Deklaratë për aplikimin dhe certifikatë përpara pagesës
 - o Certifikat nga AKU për arritjen e standarteve minimale kombëtare për sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik për të gjithë aktivitetin shoqëror me check listën për investimet: Investim në fabrika për fruta/perime;
 - Investim në fabrikat e përpunimit të verës;
 - Investim në fabrikat e grumbulli it dhe përpunimit të qumështit;
 - Investim në fabrika për përpunimin e mishit
 - Investim në thertore
 - Shoqëruar me listën e kontrollit
- Entin Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, deklaratë që provojnë përmbushjen e standarteve të kërkuara sipas procedurës – autorizim që farat dhe fidanër janë të çertifikuara dhe të rregjistruar në regjistrin kombëtar;
- Ministria e Drejtësisë
 - o vërtetim që aplikanti nuk ka qënë i dënuar më parë - Dëshmia e penaltetit;
 - o vërtetim nga Prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
 - o vërtetim nga Gjykata që nuk ka një vendim të formës së prerë.
- Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për vërtetimin që investimi plotëson standartet për sigurinë në punë shoqëruar me checklistën përkatëse;
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit
 - o Deklaratë që investimi do të përmbushë standartet kombëtare dhe të BE për ndikimin në mjedis në fund të investimit, sipas masës shoqëruar me check-listën përkatëse;
 - o Deklaratë që investimi ka përmbushur standartet kombëtare dhe të BE për ndikimin në mjedis sipas masës, shoqëruar me checklistën përkatëse;
- Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë – vërtetim për financim të dyfishtë dhe të dhënat e institucionit dhe të dhënat lidhur me fondet dhe realizimin e pagesave dhe konfirmimit të tyre – Sistemi i Thesarit.

Workflow i një aplikimi:

Aplikanti:


- Plotëson online formularin e aplikimit, përzgjedh masën për të cilën aplikon;
- Ngarkon dokumentacionin që mund të marrë me nënshkrim elektronik;

- Ngarkon dokumentacionin original të skanuar, i cili nuk mund të sigurohet nga institucione shtetërore;
- Dërgo aplikimin dhe merr një kod unik aplikimi nëpërmjet të cilit identifikohet dhe mund të gjurmohet fazën e aplikimit dhe mbi bazën e të cilit mund të ngarkojë dokumentat shtesë të kërkuara;
- Informohet për statusin e aplikimit përmes portalit e-Albania;
- Njoftohet zyrtarisht në hapsirën e tij të dedikuar në portal për hapat e ndryshëm të ecurisë së dosjes, njoftime të cilat kanë të bëjnë me shqyrtimin administrative të dosjes deri në vendimin final të saj, procesi i monitorimit të kontratës, deri në përfundim të investimit dhe pas përfundimit të kontratës.

Llojet e Aplikimeve:

Aplikanti mund të aplikojë nëpërmjet e-Albania për aplikimet mbi Skemat Direkte dhe si biznes për aplikimet mbi Investimet.

Figura nr.3 Krijimi i aplikimit të ri



Burimi: Sistemi SMI Skemat Kombëtare

- Përsa i përket aplikimit në lidhje me masat direkte aplikanti logohet në eAlbania si qytetar me të dhënat e tij personale dhe kryen aplikime mbi masat direkte, ku për çdo masë mund të kryej vetëm një aplikim. Aplikanti zgjedh llojin e fermerit dhe vendos NIPT e tij të fermerit, ose biznesit. Në background kryhet ndërveprimi me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve ose QKB duke marrë vlerat për fushat e tjera. Aplikanti plotëson të dhënat e tij mbi adresën duke zgjedhur Qarkun, Bashkinë dhe Njësinë Administrative, plotëson Fshatin dhe Adresën. Në hapin e radhës aplikanti zgjedh masën për të cilën do të aplikojë dhe plotëson të dhënat e aplikimit. Më tej konfirmon hapin e deklaratës në sistem dhe në fund dërgon aplikimin e tij.

- Përsa i përket aplikimit në lidhje me masat e investimeve theksojmë se për periudhën objekt auditimi, procesi nuk është realizuar asnjëherë online, si për pjesën e aplikimit ashtu edhe për trajtimin e aplikimit nëpërmjet sistemit. Aktualisht sistemi është përshtatur që për masat e investimeve aplikanti logohet në eAlbania si biznes me të dhënat e administratorit të kompanisë dhe kryen aplikime mbi masat e investimeve, ku për masën 7 mund të kryejë më shumë sesa një aplikim, ndërsa për masën 8 mund të kryejë vetëm një aplikim. Me anë të NIPT të loguar merren të dhënat mbi kompaninë nga QKB. Më tej aplikanti plotëson të dhënat e tij mbi adresën duke zgjedhur nga dropdown Qarkun, Bashkinë dhe Njësinë Administrative, plotëson Fshatin dhe Adresën. Në hapin e radhës aplikanti zgjedh masën për të cilën do të aplikojë dhe plotëson të dhënat e aplikimit. Shton dokumentat shtesë të nevojshme, plotëson vendodhjen e investimit dhe në varësi të masës Zërat e investimit. Më tej konfirmon hapin e deklaratës në sistem dhe në fund dërgon aplikimin e tij.

Rrjedha e punës në mënyrë të përgjithshme në AZHBR:

Pas ardhjes së aplikimeve në sistem dhe mbylljes së thirrjes, procesimi i aplikimeve fillon nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm kalon aplikimet një nga një ose në grup tek Drejtoria e DPAP. Drejtori i DPAP kalon aplikimet një nga një ose në grup te Përgjegjësi i Sektorit për të caktuar inspektorët për Kontrollin e Aplikimeve. Përgjegjësi i Sektorit DPAP zgjedh aplikimet dhe cakton dy Inspektorë (Inspektorin e Parë dhe Inspektorin e Dytë) dhe më pas ja kalon aplikimin Inspektorit të Parë. Inspektori i Parë ka mundësi të shikojë në sistem dhe të procedojë vetëm aplikimet që i janë caktuar atij, më pas Inspektorët i procesojnë aplikimet një nga një.

Inspektorët përkatës plotësojnë Checklistat përkatëse që shfaqen në sistem dhe merr një vendim mbi aplikimet nëse është i rregullt ose për Dokumenta Shtesë.

- Drejtoria e Kontrollit si për skemat direkte dhe për investimet ndjek të njëjtën procedurë kontrolli: Drejtori i Drejtorisë i kalon aplikimet tek Përgjegjësi i Sektorit, i cili përzgjedh dy inspektorë për grup aplikimesh dhe Gjeneron Urdhërin e Punës. Për masat direkte UP gjenerohet për grup aplikimi, për masat e investimeve gjenerohet për aplikim.

Në rastin e masave direkte Drejtori i kalon aplikimet tek drejtoria e radhës e DAP, ndërsa në rastin e investimeve i kalon në DPAP për lidhjen e kontratës. Të njëjtën procedurë kontrolli ndiqet dhe për kontrollin para pagese.

- Njoftimi mbi Autorizimin e Pagesës së Grantit firmoset dhe vulozet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ja dërgon aplikantit dhe më pas aplikimet kalojnë në DEP.

Drejtorja e DEP si për skemat direkte dhe për investimet ndjek të njëjtën procedure: Drejtori i Drejtorisë i kalon aplikimet te Përgjegjësi i Sektorit, i cili përzgjedh një ose dy inspektorë për grup aplikimesh në varësi të masave dhe i kalon tek inspektori i parë. Inspektori plotëson Checklistën dhe pas kontrollit aplikimi kalon te Përgjegjësi i Sektorit. Në rastin e skemave direkte Përgjegjësi i Sektorit krijon Listat sipas Bankave dhe i kalon inspektorëve për të punuar mbi Listë Pagesat dhe Urdhër shpenzimet. Pas ndryshimeve dhe rakordimeve të nevojshme Inspektori e kalon te Përgjegjësi i Sektorit. Përgjegjësi i Sektorit konfirmon dhe firmos Listë Pagesën. Vetëm pasi kjo listë është firmosur dhe vulosur dhe nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori i Përgjithshëm atëherë ka mundësinë që të ndryshojë statusin e listës dhe aplikimit në të Ekzekutuar. Përsa i përket skemave të investimeve, aplikimi kalon nga inspektorët tek përgjegjësi e më pas te drejtori për konfirmim. Pas konfirmimit Drejtori i'a kalon sërish aplikimet Përgjegjësit të sektorit për të ndryshuar statusin në të ekzekutuar.

Më pas, Drejtoria e Monitorimit planifikon, me një afat pesë vjeçar, verifikimet në terren mbi ecurinë e biznesit dhe projektin për të cilin aplikanti ka perfutur fondet e dhëna. Ciklet për verifikim në terren mund të përsëriten dhe në përfundim, drejtoria vendos të mbylli dosjen.

Nga auditimi mbi funksionalitet e sistemit SMI Skemat Kombëtare u konstatua se:


Filtri sipas datës në sistem nuk nxjerr asnjë informacion;

- Filtri sipas "App ID", nxjerr të gjithë materialin për aplikimet, për të cilët ID e tyre përmban një nga numrat e shënuar për filtrim;


- Sistemi nxjerr error si më poshtë në rast se filtron sipas fushës "Të përcaktuarit":



- Gjithashtu kur vazhdon kërkimin në sistem sipas filtrave që mundëson sistemi shfaqet problematika me mesazhin “Ndodhi një problem. Në rast se problem vazhdon, ju lutem kontaktoni administratorin e sistemit” si më poshtë:



- Në rastin e të dhënave të cilat merren me ndërveprim nga Sistemet RUDA, ISSH etj, sistemi nuk të jep mundësin e mbylljes së tab-it me informacionin përkatës, por sistemi të detyron të kthehesh tek faqja kryesore duke të nxjerrë nga aplikimi për të cilën është filtruar.



Nga auditimi mbi kontrollin për financim të dyfishtë nëse përfituesi është debitor ndaj MBZHR dhe AZHBR konstatohet se, formatet standarde për të kryer këto verifikime nuk realizohen nëpërmjet sistemit. Nga komunikimet dhe pyetësorët me personat të cilët merren me verifikimin e tyre, konstatohet se bëhet kontrolli manualisht nga punonjësit e sektorit të Menaxhimit të Borxhit për secilin aplikim të bërë sipas formateve në excel që update-ohet për çdo vit nga AZHBR, si dhe bëhet kontrolli i tyre me informacionin e marrë sipas formateve të ruajtura nga MBZHR. Më pas punonjësit vetëm check-ojnë listat në sistem sipas fazës së përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekeve dhe Autorizimit të Pagesave. Ky kontroll i cili bëhet nga punonjësit mund të standarditet dhe zhvillohet nëpërmjet sistemit duke shmangur punën voluminoze e cila bëhet manualisht jashtë sistemit për secilin aplikim, situat e cila mund të mbarti riskun e gabimeve njerëzore.

Nga auditimi u konstatua se, nuk është mundësuar ankimimi i aplikantëve nëpërmjet sistemit SMI Skemat Kombëtare në lidhje me ankesat që aplikanti ka mbi vendimmarrjen e AZHBR-së për pjesën e skemave kombëtare. Ky funksionalitet është përcaktuar tek manuali i përdorimit të sistemit. Konstatohet se, aplikanti vazhdon depoziton ankimimin e tij me shkrim dërguar në adresën e AZHBR-së apo çdo mënyrë tjetër/e-mail të aksesueshëm për ankimim. Ankesat trajtohen në mënyrë fizike dhe lajmërohet aplikanti nëpërmjet telefonit ose emailit.

Nga ekstrakti mbi userat e sistemit konstatohet se aktualisht sistemi SMI Skemat Kombëtare disponon 144 usera, nga të cilët 121 janë aktiv dhe 23 janë inaktiv.

Nga auditimi i userave të hapur në sistem konstatohet se:

- egzistojnë role të cilët nuk janë të përcaktuar në kontratën dhe në manualin e përdorimit të sistemit, konkretisht roli: “Lexues i Fermës”, “Audit i Jashtëm”, “Audit”,

“Administrues i Përdoruesve”, “Autorizues i Fermës”, duke sjellë risk në ndërhyrje të paautorizuara;

- egzistojnë usera të paidentifikuar si: Inspektor1 Sla me adresë email-i inspektor1.sla@azhbr.gov.al dhe Inspektor2 Sla me adresë email-i inspektor1.sla@azhbr.gov.al;
- roli “Oficeri i Sigurisë”, nuk është parashikuar të ket akses në sistem me qëllim kontrollin e llogarive të përdoruesve;
- përdoruesit e agropikave nuk kanë akses në sistem, ku sipas kontratës aktuale të përmirësimit të sistemit sistemi ka rol për “Përdoruesit info Aplikimi Agropika”;
- përdoruesi me rolin “Audit” si dhe veprimet që kryen në sistem nuk është i përcaktuar në manualin e përdorimit të sistemit.

➤ Për periudhën objekt auditimit në zbatim të pikës 2 të Vendimit nr. 130, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024”, pikat a), b), c), ç), d), dh) dhe e) dhe udhëzimeve të sipërcituar në fuqi, aplikimet janë bërë online nëpërmjet portalit e-Albania dhe trajtuar nëpërmjet sistemit SMI Skemat Kombëtare Online, konkretisht pikat sipas vendimit:

“a) pagesa në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë. Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB)”;

b) pagesa në vlerën deri në 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi. Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”;

c) mbarështim i bletarisë në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje. Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”.

ç) pagesa në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezona, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha. Për sipërfaqen mbi 5 (pesë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”.

d) pagesë për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/ha, për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha. Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”.

dh)fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore...”

Nga auditimi konstatohet se gjatë fazës së terrenit, Vendimi i sipërcituar nr. 130, datë 06.03.2024 është përditësuar me Vendimin Nr. 581, datë 18.09.2024 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 130, datë 06.03.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për Bujqësinë e Zhvillimin Rural, për vitin 2024”, pas pikës 2.2 shtohet pika 2.3, për Mbështetje për investime në ferma, konkretisht për masat:

- a) Për ndërtimin e serrave diellore të reja, me sipërfaqe jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha dhe jo më shumë se 2 (dy) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se: - 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve; - 8 000 000 (tetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë; - 4 000 000 (katër milionë) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve;
- b) Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Në këtë rast, financimi bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha;
- c) Për ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imëta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) shpendë. Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt;
- ç) Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt;
- d) Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt...”

Gjithashtu ka dalë Udhëzimi nr. 22, datë 19.09.2024 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financës “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.06, datë 07.03.202”, në të cilin përveç kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përfituesve pika 3, shkronja b, citohet se:

“b. Aplikimit për masat mbështetëse të investimeve me nr. 9-13 do të bëhen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR”, si dhe përcaktohet afati i aplikimeve nga data 30.09.2024 deri më 08.11.2024, brenda orarit zyrtar.

Nga auditimi konstatohet se, aplikimet për masat e investimeve për vitin 2024 po realizohen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR. Aplikimet mund të kryhen nëpërmjet sistemit SMI Skemat Kombëtare duke qenë se janë zhvilluar dhe testuar konfigurimet/funksionalitetet mbështetur edhe nga manuali i përdorimit për kryerjen e aplikimeve si dhe trajtimin e tyre nëpërmjet sistemit gjë që do të lehtësonte procesin e dorëzimit të dokumentacionit nga aplikanti i cili aktualisht është i detyruar të paraqitet në zyrat qendrore të institucionit. Kjo situatë mbart riskun e mospërdorimit të sistemit në të ardhmen duke mos arritur qëllimin e tij kryesor për të cilin AZHBR ka investuar e cila si pasojë mund të sjellë investim pa efektivitet për këtë sistem.

➤ **Regjistrimi i bazave të të dhënave shtetërore**

Nga auditimi konstatohet se AZHBR për sistemet SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare të cilat i ka në administrim dhe përmbajnë të dhëna parësore dhe të rëndësishme që gjenerohen vetëm nga AZHBR, ende nuk e ka përfunduar procesin e regjistrimit si të dhëna shtetëror, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, përkatësisht në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se sistemet SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare ndërveprojnë duke marrë të dhëna nga databaza të tjera shtetërore të sipërcituar në këtë akt konstatim. Duke qenë në këto kushte sistemet SMI IPARD dhe Sistemi SMI Skemat Kombëtare nuk mund të ndërveprojnë me sisteme të tjera që janë klasifikuar si bazë e të dhënave shtetërore, veprim ky në kundërshtim me:

- Nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore” ku citohet se: “1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore. 2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore”;
- Nenin 9, pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të dhënave shtetërore” ku citohet se: “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore”.

- Kodi burim i sistemeve SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare:

Përsa i përket kodit burim të sistemeve të implementuara, konstatohet se AZHBR nuk e disponon kodin burim për të dy sistemet SMI IPARD dhe Sistemi SMI Skemat Kombëtare. Nga auditimi konstatohet se kodi burim i të dy sistemeve administrohet nga AKSHI si Autoritet Kontraktor i cili ka lidhur kontratat për të dyja sistemet ku është specifikuar tek kushtet e kontratës “Të drejtat e aplikacionit”, citohet se: “Të gjitha të drejtat mbi kodi burim dhe dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të sistemit apo pajisjeve, skica etj) do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor. Sistemi do të dorëzohet i shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar së bashku me setin e dokumentacionit teknik që përfshin dokumentacionin teknik të moduleve në veçanti dhe dokumentin teknik në tërësi.”

Nga auditimi konstatohet se AZHBR për të dy sistemet që disponon nuk ka marrë kodin burim të ndërtimit të sistemeve të implementuara nga operatori i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tyre, në kundërshtim me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, të Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI.

Nga auditimi për të dy sistemet SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare u konstatua se:

- Nuk janë përcaktuar pozicionet e punës apo punonjësit që nevojitet të kryejnë detyra administrative të sistemeve me anë të një shkrese zyrtare nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR-ës;
- Nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkrese ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-rol, duke sjell risk potencial në përcaktimin e të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve;
- Atributet dhe rolet e userave në sistemet nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës;
- Kriteret e detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit në sistemin SMI IPARD sipas manualit të procedurave të drejtorisë, për administrimin e përdoruesve dhe administrimin e fjalëkalimeve (“E-9.0-1.3 Password Management Guideline”) nuk përputhen me kriteret e aplikuar në sistem.
- Opsioni “Dil” nuk është komand e zbatueshme nga ana e sistemit, pasi përdoruesi mbetet i loguar në sistem edhe pas shtypjes së këtij opsioni. Për të dy sistemet qëndron e hapur sesioni i log-in, vetëm pasi përdoruesi detyrohet manualisht të fshijë historikun e Browser-it atëherë bëhet dalja nga sistemi, duke lejuar që nëpërmjet sistemit të ndodhin gabime njerëzore, por dhe gabime të qëllimshme nga dikush tjetër, ku përdoruesi aktual mendon se ka dalë nga sistemi.

➤ **PRDB – Reference price database**

Gjatë vitit 2021, AZHBR me mbështetjen e GIZ - SRD (Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural) ka zhvilluar një IT Tool për përlogaritjen e çmimeve reference të tregut për mallrat dhe shërbimet. Ky projekt është zbatuar në dy faza:

1. Mbështetje e AT për forcimin e kapacitetit të stafit të AZHBR-së dhe zhvillimin e një koncepti strategjik dhe modelit të “Baza e të Dhënave të Referencës së Çmimeve” (PRDB) për AZHBR
2. Zhvillimi i një zgjidhje të bazuar në TI të “Bazës së të dhënave të referencës së çmimeve” për qëllimin e menaxhimit të IPARD.

Ky sistem është marrë në dorezim nga AZHBR gjatë vitit 2023 dhe aktualisht administrator dhe owner i këtij sistemi është AZHBR.

Sipas kontratës Nr. 8 prot., datë 16.05.2022 “Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin IPARD - për AZHBR” infrastruktura dhe serverat e sistemit të bazës së të dhënave të çmimeve të referencës (PRDB) është i hostuar në Datacenterin qeveritar në AKSHI.

Nga auditimi konstatohet se ky IT tool-s (PRDB) nuk ndërvepron me sistemin SMI IPARD Online, ku të dhënat mbi përcaktimin e çmimeve plotësohet manualisht në sistem pasi punonjësit bëjnë përllogaritjet nëpërmjet këtij IT tool-s, duke lënë hapësire dhe risk për gabime në hedhjen e të dhënave.

Nga intervistat e zhvilluara me personat përgjegjës të Drejtorisë së Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut konstatohet se për të dhënat që kanë hedhur në sistem për secilën masë, çmimi i referencës përllogaritet dhe meret nëpërmjet sistemit PRDB, ndërsa në rast se nuk ka një çmim reference bëhet një përllogaritje manuale jo nëpërmjet sistemit nga punonjësit e drejtorisë dhe ai çmim quhet çmimi i arsyeshëm.

Nga auditimi u konstatua se për sistemin PRDB, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në AZHBR nuk ka njohuritë dhe kapacitetin profesional për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi si dhe nuk është parashikuar marrëveshje e nivelit të shërbimit duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimeve dhe vazhdimësinë e punës në këtë sistem.

Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit PRDB, u konstatua se:

- ky sistem në AZHBR administrohet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, pa një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e sistemit, në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e sistemit dhe përdoruesve të sistemit;
- sistemi nuk është konfiguruar në funksion të zbatimit të parimit të “katër syve”, kjo për faktin se në periudhën e përgatitjes së sistemit nuk ishte krijuar Drejtori e veçantë dhe funksiononte EvC (Evaluation comity);
- nuk është mundësia e para regjistrimit të kursi të këmbimit për çdo Thirrje të veçantë;
- nuk është funksional këmbimi automatik pavarësisht nga monedha në të cilën është regjistruar çmimi;
- sistemi nuk ka të konfiguruar politikat e kontrollit me qëllim mos pranimit të regjistrimit të çmimeve/ofertave nga furnitorët në qoftë se nuk plotësohet periudha e vlefshmërisë sipas kriterëve të përcaktuara;
- nuk është parashikuar funksionaliteti “Ndryshimi i periudhës së vlefshmërisë” për çmimet e aseteve të regjistruara, vetëm me të drejtë shtyrjen e periudhës;
- profil i furnitorëve/subjekteve të regjistruar nuk shfaqet në sistem;
- furnitorët e regjistruar dhe të pa “validuar” nuk filtrohen me qëllim shfaqen në krye të listës së furnitorëve;
- sistemi nuk ka funksionalitetin e “Notifikimit” për çdo info të re që regjistrohen në sistem nga furnitorët;
- asetet e paaprovuara nuk shfaqen të gjitha, por sistemi të detyron përzgjedhjen e filtrit për të zgjedhur kategoritë (modul/level) dhe për të përcaktuar periudhën e vlefshmërisë;
- egzistojnë akoma rekorde test në sistemin live.

➤ **Vazhdimësia e ofrimit të shërbimit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat**

Me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash, nevojiten të hartohen plane të rikuperimit nga katastrofa (DRC), në të cilat dokumentohen masat dhe procedurat për rivendosjen në funksionim të sistemit me qëllim garantimin minimal të shërbimeve që ofrohen nëpërmjet sistemeve informatike, funksionet kritike, kohën e rikuperimit si dhe burimet njerëzore që përfshihen në rast emergjence.

AZHBR ka investuar për përmirësimin e dy sistemeve kryesore që disponon konkretisht, SMI IPARD dhe SMI Skemat kombëtare, ku për të dyja sistemet ka investuar në infrastrukturën e sistemit për Site-n Primar dhe Site-n Sekondar me qëllim sinkronizimin e site-ve në rast të rënies së njërit site.

Nga auditimi u konstatua se, AZHBR pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për ngritjen e një infrastrukture të nevojshme për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës vetëm për dy sistemet e sipërcituara, AZHBR për sistemet që ka në përdorim përfshirë dhe sistemin PRDB nuk ka rishikuar dhe përditësuar dokumentat e politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe planin e rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”. Këto dokumente të përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemeve në rastet e emergjencave dhe të sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup të dy sistemeve kryesore SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare kryhet nga Operatori Ekonomik dhe ndjekësi i kontratës, praktik kjo që përbën risk në humbjen e të dhënave dhe vazhdimësinë në ofrimin e shërbimit.

Nga auditimi u konstatua se kontraktuesit nuk i janë përcaktuar nivelet e aksesit në të dhënat e backup për sistemet që menaxhohen bazuar në kontratat e lidhura për të cilat AZHBR është përfituesi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 31.07.2023 “Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit” të AKSHI-t.

➤ **Infrastruktura ku janë hostuar pajisjet e Site Sekondar për sistemin SMI IPARD dhe infrastruktura e rrjetit në AZHBR**

AZHBR operon në një godinë tre katëshe ku gjatë vitit 2021 ka patur përmirësime në shtrimin e rrjetit fizik pas rikonstruksionit të godinës dhe shtimit të pjesës së re të godinës. Në vitin 2022 në kuadër të implementimit të Sistemit SMI IPARD III, u bë një riorganizim i rrjetit të brendshëm, duke shtuar pajisje të reja në funksion të këtij sistemi. Rrjeti është i tipit LAN i ndërtuar sipas topologjisë ‘yjl’. Në dhomën e serverave të AZHBR ndodhen dy Rack, ku në njërin janë pajisjet server dhe firewall dhe në rack-un tjetër janë pajisjet e shpërndarjes së rrjetit (VOIP dhe data). AZHBR ka dhe dy racke të tjerë të shpërndarë, në dhomat teknike nëpër kate, ku ndodhen switchet e patch panelet për shpërndarjen e rrjetit.

Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave ku funksionon dhe si Site Sekondar për Disaster Recovery Center për sistemin SMI IPARD u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverave (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike. Duke qenë se dhoma e serverave është një pikë e rëndësishme e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit. Për këtë qëllim,

grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të AZHBR-së vizitoi on-site pajisjet fizike të këtij institucioni.

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave dhe infrastrukturës network në AZHBR, u konstatuan disa problematika si mëposhtme:

- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- Nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike e përlogaritur për pesha e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pendece në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbytje;
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës;
- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- Në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, qese, dërrasa, etj) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj;
- Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC për sistemin SMI IPARD nuk përputhet me përcaktimet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në lidhje me kushtet dhe distancën e ndërtimit të një DRC-je.

Nga auditimi on-site i ambientit fizik të dhomës së serverave ku janë hostuar serverat site-it sekondar të sistemit SMI IPARD si dhe disa pajisje të tjera nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), duke riskuar ndërprerjen e shërbimeve dhe përmbushjen e qëllimit për të cilin është investuar në lidhjen me sistemin SMI IPARD si dhe me veprimtarinë operacionale të AZHBR.

- Administrimi i log-eve

Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktivitetëve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme. Në lidhje me procedurën e log review për sistemet që aktualisht AZHBR disponon, grupi të auditimit i është vendosur në dispozicion vetëm procedura “E-9.0-2.1 Soft management for IPARD” e cila është një procedurë e ndjekur për sistemin SMI IPARD II, sistem i cili nuk është më në përdorim nga AZHBR.

Nga auditimi u konstatua se:

- Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, AZHBR nuk disponon ndonjë rregullore apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e log-eve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, dhe për pasojë këto detyra specifike mbi analizimin dhe gjurmimin elektronik të tyre nuk janë adresuar në pozicione specifike, sipas praktikave më të mira, standardeve të sigurisë si dhe pikës 4 shkronja a) të “*Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike*”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT. Rregullorja duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.
- log-et e sistemeve monitorohen manualisht bazuar në kontratën e mirëmbajtjes, por ato nuk janë testuar, analizuar dhe monitoruar ndonjëherë, nëse janë të plota, funksionale dhe të përdorshme. Nuk është e përcaktuar se për sa kohë ruhen këto log-e dhe çfarë procedure ndiqet për analizimin e tyre. Koha e ruajtjes së tyre është e ndryshme rast pas rasti;

- AZHBR nuk zhvillon kontrolle mbi Audit Log, pavarësisht rëndësisë që kanë këto të dhëna në përmirësimin e sistemit, konstatimin dhe analizimin e problematikave të ndryshme.

Për sa është trajtuar në këtë drejtim të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione për Projekt Raportin.

IV. REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit (DTI) u konstatua se për periudhën objekt auditimi ka patur vakanca të burimeve njerëzore, për funksionin “specialist”, përkatësisht 1 (një) vakancë në vitin 2022, 2 (dy) në vitin 2023 dhe 2 (dy) në vitin 2024. Nga auditimi u konstatua se me urdhër të brendshëm të Titullarit të Institucionit Nr.285, datë 28.06.2022 me objekt: “Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sigurinë e informacionit në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” është caktuar zyrtari përgjegjës për sigurinë (Information Security Officer) në AZHBR, në përputhje dhe me Manualin e Procedurave. Gjithashtu, AZHBR me shkresën Nr.274/2 prot., datë 16.02.2024, me lëndë: “Kërkesë për propozim për ndryshimin e strukturës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, ka përcjellë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, relacionin lidhur me propozimin për ndryshimin e strukturës, pjesë e të cilit është dhe shtimi i pozicionit të Oficerit të Sigurisë, si nevojë e dal nga rekomandimet e auditimeve të realizuara në institucion. Zyrtari përgjegjës do të kryente të gjitha detyrat të cilat ngarkohen me urdhër të brendshëm nga Titullari i Institucionit për Oficerin e Sigurisë. Grupi i auditimit konstaton se në strukturën e miratuar në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 93, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” ky pozicion nuk është shtuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.1) faqe (8-14) të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masa për plotësimin me punonjës të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, shtimi i pozicionit të Oficerit të Sigurisë, si dhe të analizojë mënyrën e ristrukturimit të saj me sektorë, me detyra funksionale të përcaktuara.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit nuk është pjesë e Incident Response Team – IRT në kundërshtim me Manualin e Procedurave Incident Response Policy. Struktura përgjegjëse për reagimin ndaj incidenteve në AZHBR, ngritur me urdhrin Nr. 479, datë 20.09.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm, përbëhet nga: oficeri i riskut, koordinatorët e riskut të çdo drejtorie, oficeri i raportimit, oficeri i parregullsisë, oficeri për menaxhimin e burimeve njerëzore, oficeri për monitorimin dhe analizën e ndryshimeve të legjislacionit, oficeri për marrëdhëniet me publikun dhe përgjegjësi i sektorit i arkivit dhe protokollit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.1) faqe (8-14) të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të marrë masa për përfshirjen e Drejtorit të DTI-së në Grupin e Përgjigjes ndaj Incidenteve (Instant Response Team-IRT), për sigurimin e zbatimit të politikave të sigurisë në funksion të mbrojtjes së aseteve të informacionit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: AZHBR ka zhvilluar sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët, për biznesin dhe ndërveprojnë e shkëmbejnë informacione. Bazuar në analizimin e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se AZHBR nuk ka një marrëveshje në nivel shërbimi me AKSHI-n, në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të

ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, pika 2.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.1) faqe (8-14) të Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural t’i kërkojë AKSHI-t në bashkëpunim, realizimin e marrëveshjes për shërbimet e përqendruara të ofruara prej tij nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për administratën shtetërore, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet.

Brenda vitit 2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, AZHBR nuk ka plan trajnimi vjetor të miratuar për teknologjinë e informacionit, në kundërshtim me ligjin Nr. 10296 datë 16.09.2016 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 20, pika 2 ç: “Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore”.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në raportet e veta 3, 6, 9 dhe 12 mujore bën sugjerime të përgjithshme për fushat e interesit që drejtoria ka si nevoja për trajnime.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.1) faqe (8-14) të Raportit të Auditimit)

4.1 Rekomandim: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të analizojë dhe të identifikojë nevojën e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit dhe të marrë masa për miratimin e planit vjetor të trajnimeve të DTI.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm, u konstatua se:

1. Kjo strukturë nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 8 dhe 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.

2. Në strukturë mungojnë ekspertët e fushës TIK në kundërshtim me “Manualin e auditimit të brendshëm” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, pika “2.4.4 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit”.

3. Nuk janë zhvilluar burimet njerëzore me njohuri për auditimin e TI-së në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4. pika 6, neni 9 dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.1) faqe (8-14) të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandim: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të marrë masa të përfshijë në programet e auditimit të brendshëm dhe auditime IT, periodike sa herë ka ndryshime ligjore në funksionimin e sistemeve dhe infrastrukturave TIK. Gjithashtu, AZHBR të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe me punonjës të profilit përkatës dhe njohuri specifike të teknologjisë së informacionit, që gëzojnë ekspertizën e nevojshme për kryerjen e këtyre auditimeve. Punonjësit të trajnohen vazhdimisht, në përputhje me nevojat e stafit për trajnim dhe standardeve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Brenda vitit 2025 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dy sistemeve, IPARD II dhe sistemi SMI Skemat Kombëtare (i përdorur deri në vitin 2023) konstatohet se:

- Sistemi IPARD II i cili është zhvilluar nga GIZ¹, si financues dhe krijues i këtij sistemi, i është dorëzuar AZHBR-së në 21 dhjetor të vitit 2016 për administrim dhe përdorim, aktualisht nuk përdoret për realizimin e aplikimeve për fermerët, por si një arkivë elektronike për dosjet e aplikimeve. Gjithashtu, me përfundimin e kontratës së mirëmbajtjes, prej një viti sistemi është pa mirëmbajtje dhe suport. Ruajtja e të dhënave që gjenden në këtë sistem është bërë në USB, disk të jashtëm, sipas mundësive që ka patur DTI.

¹ Projekti për Zhvillimin Ekonomik dhe Promovimin e Punësimit në Bujqësi (EDEP)

- Sistemi SMI Skemat Kombëtare është implementuar që në vitin 2012 i cili aktualisht për shkak të mangësisë në kapacitete fizike nuk përdoret më për aplikimet, por shërben si arkivë elektronike për nxjerrjen e informacioneve për aplikimet e realizuara ndër vite. Gjithashtu, AZHBR nuk ka marrë masa për ruajtjen e të dhënave që ky sistem përmban, duke vënë në rrezik humbjen e informacionit që ruhet në sistem.

Kushtet teknike dhe organizative në të cilat administrohen sistemet IPARD II dhe SMI Skemat Kombëtare, vënë në rrezik të dhënat që ndodhen aty.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim ruajtjen e bazës së të dhënave të sistemit IPARD II dhe sistemit SIM Skemat Kombëtare, duke mundësuar arkivimin e informacionit të ruajtura në to, importimin e të dhënave të ruajtura në sistem për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshmërisë së të dhënave të aplikimeve që janë kryer ndër vite në AZHBR.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve mujor të mirëmbajtjes të sistemit SMI IPARD për periudhën 16.06.2023 deri në 18.06.2024 u konstatua se, çdo muaj ka pasur ndryshime/përditësime si në modulet, workflow-t dhe funksionalitetet ekzistuese nga marrja në dorëzim e sistemit. Konstatohet se përmirësimi i sistemit SMI IPARD në lidhje me funksionimin, përmirësimin e moduleve ekzistuese, trajtimin dhe procesimin e aplikimeve për të përfituar nga programi IPARD ende nuk e ka arritur qëllimin për informatizimin e të gjitha hapave të procesit nëpërmjet përdorimit të sistemit, si në lidhje me workflow-n ashtu dhe me veprimet operacionale të AZHBR-ës. Kjo situatë sjellë risk në ndërprerjen e shërbimit dhe vazhdimësisë së funksionimit të sistemit në momentin e hapjes së thirrjeve si dhe zhvillimit të të gjithë procesit nëpërmjet sistemit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit të identifikojnë, analizojnë dhe prioritarizojnë, burimet, nevojat për përmirësimin dhe përditësimin e sistemit, si dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete me qëllim finalizimin e plotë të të gjithë procesit të informatizuar, dixhitalizuar dokumentat dhe proceset sipas veprimeve operacionale dhe nevojës së përdoruesve në sistem.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit dhe rolet e krijuara në sistemin SMI IPARD dhe sistemin e ri SMI Skemat Kombëtare, u konstatuan disa parregullsi.

Në sistemi SMI IPARD, janë krijuar 102 përdorues, nga të cilët 79 janë aktiv dhe 23 janë inaktiv, duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë. Parregullsitë që u identifikuan nga auditimi janë:

- 29 përdorues nuk kanë asnjë rol të krijuar në sistem, nga këto 10 janë aktiv në sistem dhe 19 janë inaktiv.
- Rolet “Parregullsi”, “administrator përdoruesi” nuk janë krijuar në përputhje me manualin e përdorimit të sistemit, konkretisht sipas paragrafit “Rolet e Përdoruesit”;
- Roli “Oficeri i Sigurisë”, është inaktiv, si dhe nuk i është caktuar personit përgjegjës për detyrat e Oficerit të Sigurisë.
- Emërtimet e roleve të krijuara në sistem nuk janë në përputhje me manualin e përdorimit, konkretisht sipas paragrafit “Rolet e Përdoruesit”.
- Nuk është funksional roli “Edituesit të Aplikimit” i cili sipas Manualit duhet të ketë opsionet për masat dhe ndryshimet e aplikimit për thirrje.
- Ekzistojnë role të përcaktuara në Manualin e përdorimit për të cilën nuk dihet funksionaliteti për të cilin është krijuar, konkretisht roli E_ALBANIA – rol i sistemit nga e-Albania për tu lidhur me aplikimet IPARD, i fshehur në Aplikacion.

Në sistemin SMI Skemat Kombëtare, janë krijuar 144 përdorues, nga të cilët 121 janë aktiv dhe 23 janë inaktiv, duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë. Parregullsitë që u identifikuan nga auditimi janë:

- Rolet e hapura në sistem si: “Lexues i Fermës”, “Audit i Jashtëm”, “Audit, “Administrues i Përdoruesve”, “Autorizues i Fermës” nuk janë përcaktuar në kontratën dhe në Manualin e përdorimit të sistemit. Këto role nuk kanë detyra të përcaktuara duke sjellë risk në akses të paidentifikuar në sistem.
- Janë krijuar përdorues me të dhëna të përgjithshme që nuk identifikojnë një punonjës specifik si: Inspektor1 Sla me adresë email-i inspektor1.sla@azhbr.gov.al dhe Inspektor2 Sla me adresë email-i inspektor1.sla@azhbr.gov.al, duke sjellë risk në akses të paidentifikuar në sistem.
- Roli “Oficeri i Sigurisë”, nuk është parashikuar të ketë akses në sistem me qëllim kontrollin e llogarive të përdoruesve.
- Përdoruesit e agropikave nuk kanë akses në sistem, ku sipas kontratës aktuale të përmirësimit të sistemit ka rol për “Përdoruesit info Aplikimi Agropika”.
- Përdoruesi me rolin “Audit” si dhe të drejtat e këtij roli nuk janë përcaktuar në Manualin e përdorimit të sistemit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit të marrin masa për analizimin e identifikimit të hollësishëm të përdoruesve të sistemit, bllokimin e aksesit dhe çaktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët nuk janë të lidhur me përdorues të identifikueshëm, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se aplikimet për masat e investimeve për vitin 2024 po realizohen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR, megjithëse këto aplikime mund të kryhen përmes sistemit të ri SMI Skemat Kombëtare, pasi konfigurimet dhe funksionalitetet e nevojshme janë zhvilluar dhe testuar. Mospërdorimi i sistemit rrezikon të kufizojë efektivitetin e tij në të ardhmen, duke penguar arritjen e qëllimit për të cilin AZHBR ka investuar dhe duke e kthyer këtë investim në një shpenzim të paefektshëm.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për automatizimin e shërbimeve për të cilat është investuar për këtë sistem, duke vendosur në funksionim të plotë fillimin e përdorimit dhe popullimin e moduleve në lidhje me aplikimet e masave për investim të cilat janë implementuar në sistem nga të gjitha strukturat sipas detyrave dhe funksioneve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Kanë rezultuar probleme me funksionalitetet e filtrave në sistem:

- Filtri sipas “App ID” jep të gjitha aplikimet që përmbajnë një nga numrat e filtruar, duke mos ofruar rezultate të sakta.
- Filtri sipas datës nuk kthen asnjë rezultat, duke mos shfaqur asnjë informacion;
- Filtri sipas fushës “Të përcaktuarit” gjeneron error në sistem, duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë.
- Gjatë përdorimit të filtrave të tjerë, shfaqet mesazhi i gabimit: “Ndodhi një problem. Në rast se problem vazhdon, ju lutem kontaktoni administratorin e sistemit.”

Ndërveprimi me sisteme të tjera (RUDA, ISSH, etj.):

- Sistemi nuk lejon mbylljen e tab-it me informacionin përkatës, duke detyruar përdoruesin të rikthehet në faqen kryesore, çka ndërpret procesin e filtrimit dhe aplikimit.

Mungesa e kontrollit të automatizuar për financimet e dyfishta:

- Verifikimet për financime të dyfishta (nëse përfituesi është debitor ndaj MBZHR dhe AZHBR) kryhen manualisht nga punonjësit. Punonjësit përdorin formate excel të përditësuara çdo vit dhe i krahasojnë manualisht me informacionin e ruajtur nga MBZHR.
- Në sistem nuk ka standardizim për të automatizuar këto verifikime.

Mungesa e funksionalitetit të ankimeve në sistem:

- Sistemi i ri SMI Skemat Kombëtare nuk lejon aplikantët të depozitojnë ankesa në mënyrë dixhitale, pavarësisht përcaktimit të këtij funksionaliteti në manualin e përdorimit. Aplikantët vazhdojnë të depozitojnë ankesa fizikisht ose përmes e-mailit.
- Trajtimi i ankesave realizohet manualisht dhe njoftimi i aplikantëve bëhet përmes telefonit ose e-mailit, duke mos përdorur sistemin për transparencë dhe efikasitet.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune që të analizojë, adresojë parregullsitë dhe mangësitë e identifikuara dhe të propozojë zgjidhje konkrete, për automatizimin e plotë të shërbimeve në lidhje me:

- Përdorimin e sistemit dhe funksionalitetet e tij,
- Kontrollin e financimeve të dyfishta,
- Mundësimin e ankimimit të aplikantëve përmes sistemit SMI Skemat Kombëtare.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se AZHBR, për sistemin SMI IPARD dhe sistemin SMI Skemat Kombëtare, të cilat janë në administrimin e saj dhe përmbajnë të dhëna parësore dhe të gjeneruara ekskluzivisht nga AZHBR, ende nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të këtyre sistemeve si baza të dhënash shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Ky veprim është në kundërshtim me:

- Nenin 4.1, 4.2, 5, 7, 8, të ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012, për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar, konkretisht nenet: 5, 6, 7, 8, 9.

Të dy sistemet, SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare, ndërveprojnë duke marrë të dhëna nga databaza të tjera shtetërore, në kundërshtim me:

- Nenin 8 të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Nenin 9, pika 5, të VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores për administrimin e sistemeve të bazave të të dhënave shtetërore”.

Nga auditimi konstatohet se AZHBR për të dy sistemet që disponon nuk ka marrë kodin burim të ndërtimit të sistemeve të implementuara nga operatori i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tyre, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, të Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa konkrete për:

- Identifikimin dhe klasifikimin e të dhënave si:

- Të dhëna parësore.
- Të dhëna dytësore.
- Çdo element tjetër të nevojshëm për funksionimin dhe administrimin e bazës së të dhënave.

- Regjistrimin e bazave të të dhënave si të dhëna shtetërore, në përputhje me përcaktimet ligjore.

- Sigurimin e kodit burim për të dyja sistemet që disponon (SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare), duke garantuar kontrollin e plotë dhe mirëmbajtjen efektive të tyre. Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar përputhshmërinë ligjore, transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e të dhënave nga AZHBR.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për të dy sistemet SMI IPARD dhe SMI Skemat Kombëtare që AZHBR përdor aktualisht, u konstatua se:

- Nuk janë përcaktuar pozicionet e punës që nevojitet të kryejnë detyra administrative të sistemeve me anë të një shkrese zyrtare nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR-ës, duke sjell risk potencial të akumulimit të privilegjeve mbi administrimin e sistemit.
- Nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-rol, duke sjell risk potencial në përcaktimin e të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve.
- Atributet dhe rolet e userave në sistemet nuk janë të përcaktuara sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në Rregulloren e brendshme administrative por sipas funksionaliteteve që punonjësi ushtron në praktikë përgjatë procesit të punës, duke sjellë keqpërdorimin dhe akumulimin e privilegjeve.
- Kriteret e detyrueshme për rritjen e sigurisë së fjalëkalimit në sistemin SMI IPARD sipas manualit të procedurave të drejtorisë, për administrimin e përdoruesve dhe administrimin e fjalëkalimeve (“E-9.0-1.3 Password Management Guideline”) nuk përputhen me kriteret e aplikuar në sistem, duke sjell risk mbi sigurinë e fjalëkalimeve të përdoruesve.
- Opsioni “Dil” nuk është funksional, pasi përdoruesi mbetet i loguar edhe pas shtypjes së këtij opsioni. Për të dalë nga sistemi, përdoruesi duhet të fshijë manualisht historikun e shfletuesit, veprime të cilat nëse nuk bëhen krijojnë mundësi për gabime njerëzore dhe keqpërdorime nga përdorues të tjerë.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për përmirësimin e menaxhimit dhe sigurisë së sistemit SMI IPARD dhe sistemit SMI Skemat Kombëtare, duke përcaktuar pozicionet e punës dhe përgjegjësitë për administrimin tyre, në lidhjes me rregulloren e brendshme dhe të rishikojë dhe përditësojë kriteret për menaxhimin e fjalëkalimeve për funksionimin e opsioneve të sistemeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionaliteteve të sistemit elektronik Reference Price Database (PRDB) u konstatuan disa mangësi në administrimin dhe operimin e këtij sistemi, që mund të ndikojnë në efikasitetin e tij dhe sigurinë e të dhënave të përfshira, si më poshtë:

- Sistemi administrohet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në AZHBR, por nuk ekziston një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin dhe menaxhimin e tij, ku të përcaktohen procedurat për administrimin dhe monitorimin e sistemit dhe përdoruesve të tij.
- Sistemi nuk është konfiguruar për të zbatuar parimin e “katër syve”, sipas rregullores se brendshme të AZHBR, pasi gjatë fazës së përgatitjes së tij nuk ishte krijuar Drejtori e veçantë dhe kishte funksionuar vetëm EvC (Evaluation comity).
- Nuk është mundësuar para-regjistrimi i kursit të këmbimit për çdo thirrje të veçantë, dhe këmbimi automatik nuk është funksional, pavarësisht nga monedha në të cilën është regjistruar çmimi.
- Sistemi nuk ka politikën e nevojshme të kontrollit për të parandaluar regjistrimin e çmimeve/ofertave nga furnitorët nëse ato nuk plotësojnë periudhën e vlefshmërisë sipas kriteve të përcaktuara.
- Funksionaliteti “Ndryshimi i periudhës së vlefshmërisë” për çmimet e aseteve të regjistruara nuk është parashikuar, duke lejuar vetëm shtyrjen e periudhës.

- Profilin e furnitorëve/subjekteve të regjistruara nuk e shfaq sistemi, dhe furnitorët e pa "validuar" nuk filtrohen, duke i shfaqur ata në krye të listës.
- Sistemi nuk ka funksionalitetin për "Notifikimin" e informacionit të ri që regjistrohet nga furnitorët.
- Asetet e paaprovuara nuk shfaqen në mënyrë të plotë, duke detyruar përdoruesin të zgjedhë filtrin për të përcaktuar kategoritë dhe periudhën e vlefshmërisë.
- Akoma ekzistojnë rekorde test në sistemin live, duke rritur mundësinë për gabime.
- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në AZHBR nuk ka njohuritë dhe kapacitetin profesional për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi, dhe nuk është parashikuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimeve dhe pasigurinë e vazhdimësisë së punës në sistem.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin, adresimin e parregullsive, përmirësimin dhe rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi për sistemin PRDB dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete për to me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AZHBR:

- Nuk ka rishikuar dhe përditësuar dokumentet e politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe planin e rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery), duke mos garantuar vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve në raste emergjencash, në kundërshtim me pikën 1, shkronjat c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*", i ndryshuar.

- Nuk ka evidentuar sistemet kritike për ofrimin e shërbimeve 24 orë në 7 ditë të javës, çka rrezikon sigurinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve të ofruara, në kundërshtim me pikën 1, shkronja b), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*" i ndryshuar.

- Nuk janë përcaktuar nivelet e aksesit në të dhënat e backup për sistemet që menaxhohen bazuar në kontratat e lidhura, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 31.07.2023, "*Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit*" të AKSHI-t.

Këto mangësi përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për integritetin, sigurinë dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe shërbimeve që AZHBR ofron.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e sistemeve dhe të dhënave kritike, përcaktimin e qartë të niveleve të aksesit për Kontraktuesit në kontratat e mirëmbajtjes dhe përditësimit e planeve të vazhdimësisë së biznesit (BCP) dhe rikuperimit nga katastrofa (DRP), duke përfshirë procedura të detajuara për backup të sistemeve, pajisjeve dhe të dhënave. Këto masa synojnë garantimin e sigurisë së informacionit, uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe sigurimin e vazhdimësisë së punës për të përmbushur qëllimin dhe funksionin e AZHBR-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dhomës së serverave u konstatua se, kushtet teknike nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, të cilat mund të vënë në rrezik ndërprerjen e shërbimeve dhe përmbushjen e qëllimit për të cilin është investuar në lidhjen me

sistemin SMI IPARD si dhe me veprimtarinë operacionale të AZHBR. Parregullsitë e konstatuara nga auditimi janë si më poshtë:

- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday).
- Nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike e përllogaritur për peshë e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pjerrësi në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbajtje.
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës.
- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planin e emergjencës sa i përket sistemit elektrik.
- Në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kablllo, qese, dërrasa, etj.) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.
- Site-it i ndërtuar për Disaster Recovery Center për sistemin SMI IPARD ndodhet në AZHBR, e cila nuk është në përputhje me përcaktimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për të garantuar rikuperimin nga fatkeqësitë.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për përmirësimin e kushteve të ambienteve të dhomës së serverave, në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat sigurojnë garantimin e vazhdimësisë së punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- AZHBR nuk disponon një rregullore apo udhëzues të përcaktuar për ruajtjen, administrimin dhe analizimin e log-eve të gjeneruara nga pajisjet dhe sistemet, duke mos adresuar detyrat e analizimit dhe gjurmimit elektronik në pozita specifike, sipas praktikave më të mira dhe standardeve të sigurisë, si dhe në përputhje me pikën 4, shkronja a) të “*Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike*”, miratuar me Urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike - AKSK.
- Log-et e sistemeve monitorohen manualisht bazuar në kontratën e mirëmbajtjes, por ato nuk janë testuar, analizuar dhe monitoruar për të vlerësuar nëse janë të plota, funksionale dhe të përdorshme. Gjithashtu, nuk është përcaktuar periudha e ruajtjes së këtyre log-eve dhe procedura që duhet ndjekur për analizimin e tyre, ndërsa koha e ruajtjes ndryshon në mënyrë të rastësishme.
- AZHBR nuk zhvillon kontrolle mbi Audit Log, pavarësisht rëndësisë së këtyre të dhënave për përmirësimin e sistemeve dhe për identifikimin dhe analizimin e problematikave të mundshme.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.3) faqe (34-52) të Raportit të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë masa për hartimin e një rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit duke specifikuar me detaje pajisjet dhe sistemet për të cilat do të ruhen gjurmët elektronike, vendin e ruajtjes së tyre, veprimet e përdoruesve për të cilat ruhen këto gjurmë, periudhën e ruajtjes, si dhe strukturën përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e këtyre gjurmëve, si dhe detyrat e përgjegjësitë e çdo departamenti dhe pozicioni pune që merr pjesë në këtë proces.

Brenda vitit 2025

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në 4 prej tyre u konstatua se, afati i kontratëve të mirëmbajtjes të nënshkruara ndërmjet palëve prej 9-10 muaj, është në kundërshtim me VKM nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, pika 2/b në të cilën përcaktohet se, institucionet të cilat

kanë sisteme ekzistuese duhet të parashikojnë këtë marrëveshje për mirëmbajtjen e sistemeve dhe kohëzgjatja e saj nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.2) faqe (14-34) të Raportit të Auditimit)

17.1.Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të respektojë afatet në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi për çdo procedurë që do të zhvillojë në të ardhmen mbi mirëmbajtjen e sistemeve.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në asnjë prej dosjeve të prokurimit publik të marra në shqyrtim nuk ka një raport përmbledhës siç përcaktohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.2) faqe (14-34) të Raportit të Auditimit)

18.1.Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të hartojë një raport përmbledhës sipas formularit tip, për çdo kontratë që do të zhvillojë në të ardhmen në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në 7 prej tyre u konstatua se, në kontratat ndërmjet palëve janë përcaktuar detyrimet e porositësit, ku parashikohet se AZHBR merr përsipër zbatimin e kontratës duke ngritur një grup monitorimi për ndjekjen e procesit. Agjencia ka ngritur grupet e marrjes në dorëzim por nuk ka asnjë urdhër për grupet e monitorimit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.2) faqe (14-34) të Raportit të Auditimit)

19.1.Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural për çdo kontratë që do të zhvillojë në të ardhmen, të marrë në konsideratë ngritjen e strukturës së monitorimit të tyre.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK për vitin 2024” me shkresën nr. 2602 prot., datë 16.09.2024 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit, nga inspektori i Sektorit të Studimit të Tregut, i cili ka kryer verifikimin e shërbimit dhe ka rezultuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kontratës, për të cilën është kryer pagesa në vlerën 952,776 lekë me TVSH. Marrja në dorëzim nuk është kryer nga një grup me 3 ose më shumë persona, ku të paktën një anëtar të jetë specialist i fushës në kundërshtim me nenet 74 dhe 75 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.2) faqe (14-34) të Raportit të Auditimit)

20.1.Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të marrë masa për caktimin e grupeve të marrjes në dorëzim me 3 anëtarë, ku të paktën një prej tyre të ketë kualifikimet dhe njohuritë e nevojshme në fushën e teknologjisë së informacionit, duke marrë parasysh shërbimin që ofron me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje TIK” është lidhur kontrata e furnizimit nr. 1157, datë 04.04.2023 ndërmjet AZHBR dhe OE “K.”. Në nenin 3 të kontratës përcaktohet se furnizimi i mallit do të realizohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës. Procesverbali i marrjes në dorëzim të pajisjeve është mbajtur më 02.05.2023, pra 27 ditë me vonesë dhe në këtë rast Autoriteti Kontraktor nuk ka llogaritur dhe mbajtur penalitet me një tarifë ditore prej 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur nga çmimi total i kontratës, minimalisht mbi 25% e vlerës së kontratës e përcaktuar në nenin 7, në vlerën 52,245 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën (2.2) faqe (14-34) të Raportit të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 52,245 lekë pa TVSH nga OE “K.”, e përlloritur nga penalitetet e dorëzimit me vonesë të mallit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 37, nenin 203 pika 1 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, i kërkojmë titullarit që në varësi të kompetencave të tij ligjore, duke vlerësuar mangësitë e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” për personat përgjegjës, si më poshtë:

Për z. H.M me detyrë Oficer Sigurie.

- Nuk ka rishikuar dhe përditësuar dokumentet e politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe planin e rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery), duke mos garantuar vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve në raste emergjencash, në kundërshtim me pikën 1, shkronjat c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar.

- Nuk ka evidentuar sistemet kritike për ofrimin e shërbimeve 24 orë në 7 ditë të javës, çka rrezikon sigurinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve të ofruara, në kundërshtim me pikën 1, shkronja b), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*” i ndryshuar.

Për znj. K.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

- Nuk ka hartuar rregulloren për ruajtjen, administrimin dhe analizimin e log-eve të gjeneruara nga pajisjet dhe sistemet, duke mos adresuar detyrat e analizimit dhe gjurmimit elektronik në pozita specifike, në përputhje me pikën 4, shkronja a) të “*Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike*”.

- Për mos marrje masash në lidhje me konstatimet mbi problemet e funksionaliteteve të filtrave në sistemin SMI Skemat Kombëtare duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë.

- Për mos marrje masash në lidhje me parregullsitë e identifikuara mbi përdoruesit dhe rolet e krijuara në sistemin SMI IPARD dhe sistemin SMI Skema Kombëtare, duke sjellë risk në akses të pidentifikuar në sistem dhe kushte për shkelje të sigurisë.

D.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “*Vërejtje*” përkatësisht:

Për znj. E.S me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm.

Për z. O.M me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT